



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE

Studime të ciklit të dytë

Punim masteri

Koncepti i islamit politik tek Izetbegoviqi

Mentor: Prof.Dr. Ali Pajaziti

Kandidati: Muxhahid Ismaili

Shkup, 2019

ABSTRAKT

Punimi në fjalë *Koncepti i islamit politik tek Izetbegović* tenton që të trajtojë dhe analizojë definicionin dhe (keq)interpretimet e konceptit *islam politik* dhe impaktet e tija në hemisferën ballkanike, e veçanërisht interpretimin dhe idetë politike të mendimitarit boshnjak, Alija Izetbegović. Në këtë punim përmes metodës krahasuese, jemi munduar që të konceptojmë dhe zhvillojmë mendimet e ndryshme teorike të akademikëve lindorë, perëndimorë dhe myslimanë mbi konceptin *islam politik*, zanafillën dhe përfaqësuesit e saj, opinionet, elaborimet mbi këtë koncept, dallimet mes islamit dhe islamizmit, islamizmin Ballkanik, partinë politike SDA (Stranka Demokratske Akcije – Partia e Aksionit Demokratik) dhe shtrirjen e saj në republika të ish-Jugosllave dhe mendimet fetaro-politike të liderit Alija Izetbegović. Ndryshe, përpos rrjedhshmërisë dhe zhvillimit ideor të konceptit islam politik apo islamizëm, një vend të veçantë në këtë punim gjithashtu zënë edhe opusideor i Izetbegovićit, në veçanti ai filozofik dhe politik. Punimi përqendrohet mbi analizën e tre veprave të Izetbegovićit që kanë të bëjnë me subjektin tonë: ‘‘Deklarata islame’’, ‘‘Islami ndërmjet lindjes dhe perëndimit’’ dhe ‘‘Problemet e rilindjes islame’’.

Fjalët kyçe: *islam politik, islamizëm, Alija Izetbegović, SDA/PAD, Deklarata islame*

ABSTRACT

This master thesis titled as *The concept of political islam at Izetbegovic*, tries to analyse the definition and the (mis)interpretations of the concept *political islam* and its fluidity on the Balkan hemisphere. The fundamental approach of the this work is interpretation of the political ideas of the Bosnian thinker and politician, Alija Izetbegovic. Using comparative method we focused different theoretical approaches from the Western, Eastern and Muslim scholars on the concept *political islam*, its origin and representatives, different approaches on the concept itself, differences between the islam and islamism, its development and impact on the Balkans, the political party SDA – Party of Democratic Action and its Balkan countries, as well as the political and religious thoughts of the Izetbegovic. Furthermore, beside the analysis on the concept of *political islam or Islamism*, , one of the major part of this work deals with the political and religious ideas of Izetbegovic, specifically elaborates the three major books of the author: “Islamic Declaration”, “Islam between East and West” and “Problems of the awakening of the Islam”.

Keywords: *Political islam, Islamism, , Alija Izetbegovic, Party of Democratic Action – PDA/SDA, Islamic Declaration*

АБСТРАКТ

Овој труд под наслов *Концептот на политичкиот ислам на Изетбеговиќ* го анализира концептот на политичкиот ислам и неговите рефлексии на Балканот, особено се фокусира врз интерпретацијата на политичките идеи на босанскиот мислител и политичар, Алија Изетбеговиќ. Во оваа теза, преку компаративниот метод се фокусираат различните теориски мисли на источните, западните и муслиманските интелектуалци за концептот на политичкиот ислам, за неговото потекло и претставниците на оваа струја, мисинтерпретациите за овој концепт, разликите меѓу Исламот и исламизмот, импактот на политичкиот ислам врз Балканот, политичка партија СДА (Stranka Demokratske Akcije – Партија за Демократска Акција), и нејзината експанзија на Балканот, религиозно-политичките мисли на Изетбеговиќ. Важен дел од овој труд се и анализите на три релевантни дела на Изетбеговиќ: "Исламската декларација", "Исламот меѓу истокот и западот" и "Проблемите на Исламската ренесанса" во контекстот на политичкиот ислам.

Клучните зборови: политички ислам, исламизам, Алија Изетбеговиќ, СДА/ПДА, Исламската декларација

Formatted: Macedonian (North Macedonia)

Formatted: Macedonian (North Macedonia)

PËRMBAJTJA

Abstrakt	2
Parathënie	6
<i>Kapitulli I – Islami politik</i>	
1.1. Islami politik: Ç’ është ky?.....	9
1.2. Islami dhe Islamizmi.....	13
1.3. Gjeneza e Islamit politik.....	18
1.4. Përfaqësuesit e islamit politik.....	21
<i>Kapitulli II – Jeta dhe vepra e Alija Izetbegoviqit</i>	
2.1. Jeta dhe vepra e Alija Izetbegoviqit.....	25
2.2. Islami politik në Ish- Jugosllavi (vitet e 90 - ta).....	32
2.3. SDA (Stranstke Demokratske Akcije – Partia e Akcionit Demokratik).....	35
2.4. Sanxhak.....	41
2.5. Kosovë.....	43
2.6. Maqedoni.....	44
<i>Kapitulli III – Librat fetaro-politike të Izetbegoviqit</i>	
3.1. Analizë e librave fetaro-politike të Izetbegoviqit.....	46
3.2. Deklarata islame.....	49
3.3. Islami ndërmjet lindjes dhe perëndimit.....	52
3.4. Problemet e rilindjes islame.....	55
Përfundimi.....	57
Literatura e shfrytëzuar.....	59

Formatted: German (Germany)

PARATHËNIE

Islami dhe politika a janë dy koncepte të ndara? Nëse këto dy koncepte kanë dallime diametrale, atëherë çfarë është “islami politik”? Koncepti “islam politik”, a është më tepër fetar apo politik? Ky definicion a është rrjedhojë e politikës globale, apo vetëm islami brenda vetes ka politikë. Përkufizimi kompleks i këtij narracioni përveç se mund të ketë kuptimin pozitiv lehtësisht mund edhe të keqinterpretohet, siç kanë ndodhur keqdefinime nga akademikët lindorë, ata perëndimorë por edhe nga vetë myslimanët. Ndikimi i masmediave, padyshim se është një ndër faktorët më relevantë që ky narracion merr edhe trajtën e keqkuptimeve të veta = a që shpërfaqet përmes termave “fundamentalizëm islamik”, “ekstremizëm islamik”, “radikalizëm islamik”, “islamofobi”, “rrezik islamik”, “terrorizëm islamik” etj. Islamistët konceptin “islam politik” e shohin në këndvështrim të fesë së ideologjizuar¹.

Përmes këtij punimi, do të mundohemi që t’i gjejmë dallimet mes këtyre koncepteve, si dhe të arrijmë që të kuptojmë botën politike-islame të mendimtarit, filozofit dhe liderit boshnjak Alija Izetbegović, për të cilin Islami dhe politika ishin harmonizimin i jetës private dhe politike të tij.

Qëllimi i punimit në fjalë, do të jetë hulumtimi dhe analiza krahasuese e konceptit të “islamit politik”, në mënyrë krahasuese tek bota e mendimit perëndimor, lindor dhe mysliman. Përpos analizës së përfaqësuesve të islamit politik, të “islamistëve”, do të angazhohemi që gjatë këtij punimi t’i interpretojmë dhe analizojmë mendimet, idetë dhe veprat e Izetbegović, pra të bëjmë një analizë të diskursit të tij lidhur me temën që po e trajtojmë. Teza e masterite titulluar “*Koncepti i islamit politik tek Izetbegović*” ka për qëllim: a) ta analizoj konceptin “islam politik” dhe të trajtoj idetë /mendimet, shkrimet fetaro-politike të mendimtarit me nam të sipërpërmendur.

Ndryshe, ky punim i bazuar mbi metodën analizës krahasuese, të përmbajtjes, të ligjëratës, është e ndarë në 4 kapituj kryesore:

a) Në kapitullin e parë bëhet përkufizimi i “islamit politik”, zbërthehet zanafilla e tij, përfaqësuesit e tij, (keq)interpretimet e tij, ndarjen e prerë të

¹ Ahmet Emin Dağ & Ali Pajaziti, *Fjalor i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe i diplomacisë*, Logos-A, Shkup, 2019, fq. 400.

koncepteve *islam dhe islamizëm* apo *islam politik*, ndikimin e këtij koncepti mbi shqiptarët.

b) Në kapitullin e dytë flasim për jetën dhe aktivitetin politik të Alija Izetbegoviqit. Përpos jetës dhe veprës së Izetbegoviqit do të shqyrtojmë ndikimin e “islamit politik” në ish-Jugosllavi gjatë viteve 90-t të shekullit XX, ndikimin e tij tek lëvizjet politike shqiptare dhe përfaqësuesit shqiptarë të kësaj perspektive politike. Në këtë kontekst shqyrtohet edhe formimi dhe zhvillimi i Partisë së Aksionit Demokratik (PAD)t, refleksionet e saj në Sanxhak, Kosovë dhe Maqedoni, përfaqësuesit shqiptarë të PAD-it, ideologjia dhe profilizimi i kësaj partie si nocion i rrethit kulturor mysliman të Ballkanit.

c) Në kapitullin e tretë do të ndalemimbi idetë, mendimet dhe veprat fetaro-politike të Izetbegoviq “*Deklarata islame*”, “*Problemet e rilindjes islame*” dhe “*Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit*”. Nëpërmjet veprave, shkrimeve, eseve publicistike, maksimave, fjalive koncize, do tashqyrtojmë botëkuptimin ideologjik dhe fetaro-politik të këtij mendimtari.

d) **Pjesa e fundit e punimit, është e përqendruar që të jep një parafrazim dhe përmbledhje të konceptit “islamit politik”, duke theksuar se mendimtari ballkanas-boshnjak Izetbegoviq mbetet një ndër zërat më të fuqishëm ideorë, kulturorë dhe shkencorë të myslimanëve të Ballkanit gjatë fundit të shekullit XX.**

Nga bibliografia e shfrytëzuar kemi konstatuar se *Koncepti i islamit politik tek Izetbegoviqi* është një ndër temat thuajse të patrajuara më herët në gjuhën shqipe. Burimet e shfrytëzuara në këtë punimi janë multilinguale, ku përpos atyrenë gjuhën shqipe, kemi shfrytëzuar tekste edhe nga gjuha turke, maqedonase, nga gjuha angleze dhe boshnjake. Gjatë përpilimit të këtij punimi jemi munduar që të aplikojmë metodologjinë e punës kërkimore në mënyrë që ai të marrë trajtën e një punimi shkencor.

Për në fund, dua që të shpreh mirënjohje të sinqerta për mentorin e temës, Prof. Dr. Ali Pajaziti, i cili gjatë gjithë kohës derisa isha duke shkruar këtë punim, përmes sugjerimeve dhe vërejtjeve të tij shkencore, arriti që temës në fjalë t’i jep trajtën e saj përfundimtare. Falënderime të posaçmepadyshim se meriton edhe miku familjar, profesori i mirënjohur

prizrenas Nexhat Ibrahim, i cili edhe përkundër moshës së shtyrë dhe problemeve shëndetësore, përmes sugjerimeve dhe ndihmës së madhe në gjetjen e punimeve shkencore dhe librave të ndryshëm, vazhdimisht ka qenë përkrahës dhe motivi kryesor që ky punim të arrin përfundimin e vet. Gjithashtu, i falënderohem edhe mikut tim nga Shkupi, Dr. Murtezan Idrizit, i cili më ka ndihmuar shumë në gjetjen e shumë veprave që gjetën vend me peshë në këtë hulumtim. Dhe krejt në fund, e falënderoj edhe familjen time për durimin dhe mirëkuptimin e treguar gjatë punimit të temës.

Shkup, 20 maj 2019

Kapitulli I

1.1 Islami politik: Ç' është ky?

Koncepti *islami politik* – mbetet një ndër konceptet rreth të cilit në kuadër të botës akademike ka divergjenca të mëdha. Konceptet si *islamizmi*, *panislamizmi*, *islamofobia*, *islami politik* janë koncepte ideore fleksibile që herë komentohet e zbërthene në këtë e herë në atë mënyrë.

Islami politik kritikohet si nga specialistët e politologjisë por edhe nga liderët e ndryshëm botërorë myslimanë.

Islami politik apo *islamizmi* është përpjekje e mendimtarëve, intelektualëve, lëvizjeve fetare për të arritur qëllimet e tyre shoqërore dhe politike, një maksimë që përpos ngjyrosjes fetare, islamin nga koncepti fetar e transformon drejt sistemit politik dhe shoqëror. Një koncept ideologjik i pjesës islame për të jetësuar qëllimet e tyre politike dhe shoqërore në një shtet mysliman ose jomysliman.

Lëvizja islamiste, që synon një renesancë islame përmes shpëtimit nga ngathtësia, injoranca dhe bestytnitë, bazohet në idenë se kundërshtimi efektiv ndaj kërcënimeve të qytetërimit modern evropian mund të bëhet vetëm në sajë të ndërtimit të një mendësie konform kërkesave të modernizmit. Sipas botëkuptimit islamist dekadencia e myslimanëve është pasojë e largimit nga e vërteta e islamit, kurse zgjidhja është kthimi te e vërteta e islamit, te islamizimi. Pra lëvizja islamiste është kthim te thelbi dhe një projekt modernist.² Sipas pas profesorit të shquar shqiptar Nexhat Ibrahim, “*islami është emër i një feje botërore, ndërsa islamizmi apo islami politik është forma e ideologjizuar e tij, ku lëvizjet islame me theks politik dëshirojnë të dallohen nga grupimet e tjera ideologjike politike*”³. Koncepti “islam politik” është forma ideologjizuar e fesë islame – shprehja ideologjike e islamistëve në shoqëritë myslimane dhe jomyslimane. Ndërsa, fjala “*islamist*” është atributi që i jepet veprimtarit që angazhohet në jetësimin e vizionit të tij ideologjik të islamit në shtet ose në shoqëri. Nëse i marrim parasysh këto dy fakte – pra se islami është fe hyjnore dhe se islamisti është veprimtar që nën petkun e islamit kërkon që ta ideologjizojë fenë, atëherë lehtë

Formatted: German (Germany)

² İlhan Kutluer, “İslamcılık”, vëll. 23, fq. 65-67, DiA, 2001.

³ Nexhat Ibrahim, “*Fjalori enciklopedik islam*”, Logos-A – Shkup, 2017, fq. 407.

mund të konstatojmë se “islami politik” është një rrjedhojë e aksionit dhe ndryshimeve shoqërore, ose është një narracion që na tregon se feja islame nuk duhet të mbetet vetëm nën atributin fetar, por kjo fe hyjnore e ka për obligim që nëpërmjet lëvizjeve fetare, organizatave apo kontribuuesve fetar – islamistë, të depërtojë tek populli apo shoqëria që vepron edhe në aksion politik, ideologjik dhe kulturor. “Islam politik” nënkupton myslimanin e arsimuar, mirë të edukuar dhe njohës i mirë i rrethanave shoqërore në një vend të caktuar apo shoqëri, i cili përkundër rezistencës perëndimore mundohet që ta adaptojë shoqërinë në bindjet dhe ideologjinë që i përket. Sipas sociologut Ali Pajaziti *“nevoja për shpëtimin e myslimanëve nga prapambetja arsimore, shkencore dhe teknologjike – lindi nevoja e islamizmit para botës perëndimore”*⁴. Islami politik apo islamizmi është një koncept reaksionar i ndërlikuar para syrit të perëndimorëve, ndërsa për islamistët ky koncept nënkupton islamistin aktiv para rrjedhojave historike, sociale, politike dhe civilizuese. Islamistët, dëshirojnë që nëpërmjet rrjedhojave historike, sociale, dhe shoqërore – të arrijnë elektrizimin e një shoqërie në sferën politike, qoftë ajo në një vend me shumicë popullsi myslimane ose jomyslimane.

Sipas Tarik Kulenoviçit *“ islamizmi përveç ideologjisë dhe petkut politik që ka, është edhe identiteti i myslimanit modern, kolektiv dhe individual”*.⁵ Ky konstatim i Kulenoviçit na mundëson më lehtë të vlerësojmë se koncepti mbi islamin politik është përtej religjioz, një koncept reaktiv mbi ndryshimet shoqërore në vend dhe në botë. Pra, të qenurit islamist nuk përkon me të qenurit vetëm praktikues i fesë, por bashkë me fenë kërkon edhe kontributin nda shoqërisë nëpërmjet ideologjizimit të fesë, përmes aksioneve politike. Islami politik do të thotë se islami përveç fesë është edhe sistem politik. Nëse themi se islami si fe është edhe sistem politik, atëherë i bie që feja dhe politika janë dy koncepte të lidhura mes vete dhe jo të ndara. Përkundër faktit se islamizmi nga disa intelektualë mund të paraqitet si narrativ i një rrugëtimi ideologjik politik, i njëti është një paradigmë e padefinuar mirëfilli deri më tani. Për disa islamistë por edhe për shumicën e intelektualëve perëndimorë, ky term vlerësohet si “ rrezik ” potencial për pushtetin dhe shtetin modern. Modernistët islamin politik e shohin si nocion që rrezikon themelet shtetërore, që sfidon shtetin dhe *status quo*-në e një territori.

Olivier Roy, studiues i njohur me punimet e tij mbi islamizmin, në librin e tij të titulluar *“ The Failure of Political Islam ”* (Dështimi i islamit politik), thotë se “islamistët

⁴Ali Pajaziti, *“ Fjalor i sociologjisë ”*, Logos-A, 2017, fq.275,

⁵Tarik Kulenoviç, *“ Islami politik – konceptet themelore, autorët dhe grupet e një lëvizjeje moderne ”*, Logos-A, 2012, fq.22

jetojnë dhe janë praktikues të vlerave moderne dhe nuk mund të quhen “tradicionalë”.⁶ Për të, islamistët janë një “*third world movement*” (lëvizje e tretë botërore). Sipas tij i riu i shkolluar me arsim cilësor dhe modern, i edukuar me botëkuptim modern, urban, njeri i klasës së mesme shoqërore, islaminepercepton si një nocion përtejreligjioz me kuptim ideologjik, nënkupton islamizmin⁷. Një pjesë e mirë e politologëve perëndimorë termin “islam politik” e shpjegojnë përmes sintagmave fundamentalizëm islamik, “threat from islam” (rrezik nga islami – islamofobi), reaksion ndaj perëndimit modern, fenomen post-modern etj.

Sipas John L. Esposito termi “*islami politik*” ndërthuretme termin epërhapur bashkëkohor “*fundamentalizëm islamik*”, ndonëse vetë koncepti “fundamentalist” është pasojë e lëvizjes protestante amerikane, përfshirë përpjekjen për t’i pastruar apo reformuar besimet, ndërsa në kontekstin islam termi iu referohet lëvizjeve rigjallëruese⁸. Ky konstatim i Esposito-s na jep mundësinë që të konstatojmë se islami në syrin e perëndimorëve apo thënë ndryshe – “islami politik” mbetet të shihet dhe interpretohet më shumë si koncept religjioz-fundamentalist sesa si një produkt politik i shoqërive post-moderne.

Islami politik shihet si rrezik edhe nga perëndimorët nga vetë islamistët. Disa e shohin si rrezik për Perëndimin, për disa është anti-kolonialist, për disa të tjerë nuk ekziston fare si koncept, për një pjesë të islamistëve mbetet si ideologjizim i fesë etj. Samir Amin islamizmin e percepton si *forcë politike për pushtet*. Ky konglomerat botëkuptimesh për konceptin në fjalë, rrjedh si pasojë e izmave (ideologji) të ndryshme ndër vite, sidomos pas ndryshimeve thelbësore në rendin e ri botëror. Disa kanë gjetur pesë qasje ndaj këtij nocioni: a) *Islami politik është një rrezik për Perëndimin*, b) *është armik i modernitetit*, c) *është fenomen post-modern*, d) *islami politik bashkëpunon me imperializmin*⁹.

“Islami politik” për islamistët shihet si aksion dhe lëvizje mendimesh politike – për të jetësuar fenë ideologjikisht duke u bazuar në diçka që është traditë dhe e tashme, ndërsa në opusin e shkencëtarëve shekullarë perceptohet si rrezik për shoqërinë dhe *status quo*-në shtetërore. Islamistët mendojnë se me aktivitete politike dhe shoqërore mund të kenë qasje tek populli për ndryshimet shoqërore, në njërën anë duke ruajtur traditat fetare, ndërsa në

⁶Olivier Roy, “*The failure of political islam*”, , Harvard University Press, 1994, fq. 3

⁷Po aty, fq.3,

⁸John L. Esposito, “*Fjalor i Oksfordit për Islamin*”, Logos-A, 2017, fq.106,

⁹Islam, Islami “*Egjypti ndërmjet shekullarizimit etatist dhe islamizmit politik*” (punim doktrate), UEJL, 2018, fq.60.

anën tjetër duke qenë në trend me ndryshimet botërore të arrijnë që të kontribuojnë për shtetin dhe shoqërinë. Westernistët lëvizjet islame dhe rigjallërimin e aksionit islam, e perceptojnë si rrezik për marrjen e pushtetit politik.

Bazuar në këto konstatime vlerësojmë se nocioni etimologjik i termave “islamizëm apo islam politik”, “fundamentalizëm islamik”, janë narracione dhe koncepte ku botëkuptimi thelbësor dhe ideor i tyre është vështirë që të konstatohet si definicion i prerë, mbase vet rrjedhojat historike, sociale, ndryshimet shoqërore mund t’i japin perceptim dhe nocion tjetër. Në botën globale apo post-modernemediat luajnë një rol shumë të rëndësishëm në perceptimin e koncepteve dhe ndryshimeve botërore. Impakti i tyre më qartë u pa në mbulimin medial të ngjarjes së 11 Shtatorit prej kur opinionit publik iu pompua sintagmat “islami fundamentalist”, “terrorizmi global”, “terrorizmi islam” etj.

1.2. Islami dhe Islamizmi

Dy konceptet: *islami* dhe *islamizmi* (apo *islami politik*) janë terme që kanë dallime konceptuale mes vete. Islami në vete është koncept religjioz dhe trajton dispozitat fetare dhe obligimet e njeriut ndaj Zotit, mjedisit dhe njerëzve të tjerë. Islamizmi (apo islami politik) shihet si dimension ideologjik i fesë, kurse *islamisti* është ndjekës i kësaj ideologjie.

Termi **islam** rrjedh nga fjala arabe *silm*, që ka kuptimin e paqes, nënshtrimit, dorëzimit dhe ndërgjeshmërisë së njeriut ndaj Krijuesit të vet; është fe e cila buron nga fjalët e Zotit të Gjithësisë, që janë të shkruara në “Kur’anin Fisnik”, fe monoteiste e cila nuk i drejtohet vetëm një shoqërie apo fisi, por i drejtohet gjithë botës, pra është religjion i përmasave mbarënjërzore. Kjo fenë aspektin besimor nuk ka pësuar asnjë ndryshim, pra që nga njeriu i parë, Ademit a.s. deri tek profeti i fundit Muhammedi a.s. Kjo gjendje, sipas botëkuptimit islam, është statike, pra në doktrinën islame nuk mund të ketë ndryshimengase fjala e Zotit është e përhershme, me vlerë tejkohore. Ndërsa në aspekt të ritualeve, format e islamit gjatë historisë dhe rrethanave shoqërore kanë pësuar ndryshime.

Pjesët përbërëse të islamit si fe monoteiste janë tri: a) pjesa besimore e islamit, b) pjesa praktike dhe c) pjesa juridike.

Pjesa besimore e islamit përbëhet nga gjashtë shtylla: *besimi në Zotin e Gjithësisë, besimi engjëjt, besimi në librat hyjnorë, besimi në pejgamberët (në profetët), besimi nëbotën tjetër dhe besimi në (para)caktimin hyjnor*, ndërsa **pjesa praktike** e tij përbëhet nga pesë elemente: *shehadeti* – është manifestimi verbal, ku myslimani dëshmon njëshmërinë e Zotit dhe profetësinë e Muhammed; *namazi* – lutjet ditore; *zekati*- pastrim i pasurisë ose ‘*taksa e dëlirësisë*’, pasuri e cila nga të pasurit, u ndahet të varfërve në mënyrë institucionale (dispozitë islame: 2.5% të pasurisë në dobi të të varfërve); *agjërimi*- në muajin e Ramazanit, dhe *haxhi*- vizita e vendit të shenjtë Qabes në kohë të caktuar (vizita e vendeve të shenjta përreth Mekkes). Përpos bazave besimore dhe pratike që ka islami si religjon, kjo fe në vete ka edhe ato **juridike**, të cilat janë: *Kur’ani, Sunneti (tradita profetike), ixhmai (konsensusi i dijetarëve) dhe kijasi (analogjia)*¹⁰.

Islami si fe monoteiste ngulmon në besimin e palëkundur në njëshmërinë e Zotit, nënshtrimin ndaj urdhrave të Tij, dëgjueshmërinë dhe bindjen ndaj Zotit. Kjo fe është

¹⁰Nexhat Ibrahim, “Fjalor enciklopedik islam”, Logos-A, 2017, fq. 394-395.

drejtuesi i jetesës së myslimanit, i cili duhet të jetojë sipas rregullave dhe dispozitave të saj. Në fakt, mënyrat e praktikimit të islamit mund të dallojnë, mirëpo dispozitat dhe rregullat e saj janë të njëjta për të gjithë. Me një fjalë, *islami* për myslimanin është mënyrë e jetesës, siç konstaton edhe Izetbegoviqi, ‘‘ një filozofi praktike, një drejtim përfshirës jetësor’’¹¹.

Përpos dimensionit besimor, praktik dhe juridik, **islami** ngërthen në vete edhe misionin dhe *civilizimin*.

Për këtë na shkruan edhe kolosi i madh – rilindasi shqiptar, Sami Frashëri, i cili thekson se renesansa dhe humanizmi evropian janë të ndikuar nga Islami, se: ‘‘ qytetërimi evropian ka lindur nga qytetërimi islam’’¹²

Ndryshe, islami si fe që nga fillimi i përhapjes së vet e deri më sot ka arritur që të përhapet në katër anët e botës, duke depërtuar në popuj ndryshëm, në kohëra të ndryshme dhe nëpër vende të ndryshme, duke arritur shifrën prej 1.5 miliardëithtarë. Qytetërimi islam dhe perëndimor ‘janë dy qytetërime që refuzojnë të mbeten lokal në aspekt fetar, etnik dhe kulturor’’¹³.

Misionarizimi islam ndër shekujka dhënë rezultate edhe në trojet e Ballkanit, e në veçanti ndër shqiptarë – të cilët sot numerikisht janë me shumicë myslimane.

Koncepti *civilizim apo qytetërim* është zgjerim i termit ‘‘kulturë’’ Sipas mendimtarit turk Ibrahim Kallën ‘‘qytetërim është shfaqja apo trupëzimi i një botëkuptimi (*Weltanschauung*) në dimensionin e kohës dhe hapësirës’’¹⁴. Pra, nëse koncepti *qytetërim* nënkupton elementet materiale dhe shpirtërore që kanë të bëjnë me jetën njerëzore (kulturën, fenë, shkencën, artin, rregullat, besimet, perceptimet, dispozitat etj.), atëherë lehtësisht mund të konstatojmë se edhe *islami* si fe është civilizim. Elementet fetare, politike, ekonomike, sociale reflektojnë parimet themelore të qytetërimit islam.

Islamizmi apo islami politik, ndryshe i njohur edhe si ‘‘*islam aksionar*’’ është ideja e bashkimit të gjithë myslimanëve në një shtet islamik, një formë e ideologjizuar e fesë, ku përfaqësuesit e saj islamin nuk e shohin vetëm si fe, por edhe si sistem politik ideologjik – ku sipas tyre e drejta islame (sheriati islam) perceptohet si bazë e rregullimit të jetës fetare, kulturore, juridike etj. Islamistët, angazhohen që nëpërmjet formës së ideologjizuar të fesë të

¹¹ Ali Pajaziti, ‘‘ Fjalori i sociologjisë’’, Logos-A, 2017, fq.273

¹² Sami Frashëri, ‘‘ Vepra 10’’, Logos-A, 2004, fq.29

¹³ Po aty, fq. 63

¹⁴ Ibrahim Kallën, ‘‘ Islami dhe Perëndimi’’, Logos-A, Shkup, 2011, fq.63

arrijnë jetësimin e vizionit dhe misionit të tyre për islamin në vendet dhe shoqëritë ku veprojnë, duke kritikuar gjendjen ekzistuese të islamit të përjashtuar nga rrjedhat kyç shoqërore. “Islamizmi” lehtësisht mund të merr edhe kuptim pezhorativ. Disa e cilësojnë atësi term të trilluar nga jomyslimanët, kryesisht si oponent të antiislamistëve¹⁵. Sociologu kroat Kulenović konceptin “islam politik” e percepton si reaksion ndaj Perëndimit, duke shtuar se qëllimi i islamistëve nuk është me dimension fetar, por me dimension politik: qëllimi final i tyre mbetet marrja e pushtetit në shtetin ku veprojnë”¹⁶ Islamizmi shihet edhe si koncept i mysliamanit modern që dëshiron t’i bëjë ballë Perëndimit në politikë, teknologji, arsim, infrastrukturë etj.

Profesori universitar Mohammed Ayoob islamizmin e definon si “aktivitet politik dhe mobilizim të fuqishëm popullor në emër të islamit.”¹⁷

“Islami politik” me shumë fluiditet kuptimor shihet si “sfidë e kohës moderne” si për perëndimorët ashtu edhe dhe për vetë mysliamanët. Islamizmi është nocion që nënkupton mysliamanët që dalin jashtë sferës besimore, që kanë pretendime politike apo shoqërore, që ka si target arritjen e fuqisë, pushtetit, shndërrimin e islamit në agjendë determinist social. Sipas analistit-politik amerikan Graham E. Fuller, “Islami politik kërkon dhe dëshiron që të krijojë një identitet të përbashkët që do të fitojë përparësi, së paku në aspektin e tij moral”¹⁸

Islamizmi perceptohet edhe si faktor për ndryshim shoqëror: –islamistët nëpërmjet angazhimeve të tyre në organizata apo lëvizje shoqërore tentojnë të arrijnë qëllime shtetbërëse. Këtë segment Kulenović e ndërlidh me joshjen, ndërsa Esposito si fundamentalizëm.

Islami politik është edhe modernizëm. Është modernizëm nga shkakut se vetë islamistët tentojnë që të përshtaten me rrethanat e kohës, vendit dhe konform ndryshimeve shoqërore ku jetojnë. Islamizmi është modernist ngase vetë përfaqësuesit e tij i bëjnë ballë modernitetit përmes metodave bashkëkohore. Oliver Roy islamistët nuk i sheh si tradicionalë, por si modernistë: “islamistët sociologjikisht janë grupim modern, njerëz urbanë, intelektual që kanë vizione përparimtare për vendin ku jetojnë”¹⁹ Profesori i amerikano-iranian Asef Bayat, islamizmin e sheh si organizim islam që tenton të vendos rend mes shtetit – fesë –

¹⁵ Nexhat Ibrahim, *Fjalori enciklopedik islam*, 2017, fq.407

¹⁶ Tarik Kulenović, *Islami politik*, 2012, fq.21

¹⁷ Ayoob, Mohammed “*The many faces of political islam*”, bot. The University of Michigan Press, 2008, fq.6

¹⁸ Graham E. Fuller, “*The future of political islam*”, botimi: Palgrave Macmillan, New York, 2004, fq. 17.

¹⁹ Olivier Rey, *The failure of political islam*, 1994, fq.50

moralit të grupeve islame.²⁰ Sipas tij islamizmi është zinxhir mes shtetit-fesë; islamistët tentojnë t'i shërbejnë të mirës së shtetit dhe shoqërisë ku jetojnë. Asaf nocionin "islam politik" e zëvendëson me "post-islami politik", duke theksuar se ndryshimet shoqërore në rendin e ri botëror sollën nevojën e konceptit të ri politik".²¹ Nga ana tjetër, Esposito konceptin "islamizëm" më tepër e ndërlidh me fundamentalizmin. **Intelektuali i mirënjohur palestinez-amerikan** Edward W. Saidi, në librin e tij "Shtrembërimi i Islamit" rigjallërimin e islamit në botë dhe lëvizjet islame në përgjithësi sheh si "imazh i komplikuar i islamit" sepse termi islam nuk mund të reduktohet në justifikim politik.²²

Shqiptarët me termin "islamin politik" janë njohur diku kah fundi i shek. XX, kur intelektualët e rinj shqiptarë të Ballkanit, u njoftuan me përkthimet e para të mendimtarëve rilindas islam.

Përveç këtyre kolosëve dhe mendimtarëve të ndryshëm që kanë shkruar mbi islamizmin dhe rilindjen islame si lëvizje reformiste, është edhe intelektual i prizrenas, Nexhat Ibrahim (mik i afërt i Izetbegoviqit) që ka kontribuar me shkrime për konceptin e islamizmit. Sipas tij koncepti "fundamentalizëm islam" në ish Jugosllavi ka filluar të hyjë në përdorim gjatë revolucionit islamikiranian, sidomos pas vitit 1983, me rastin e rigjykit të intelektualëve myslimanë boshnjakë apo "Procesi i Sarajevës" – ku ishte i gjykuar edhe vetë Izetbegoviqi bashkë me shokët e tij.²³

Ibrahimi "rizgimin islam" të mendimtarëve si Xhemaludin Afgani, Sejid Kutub, Muhamed Iball nuk i sheh si reaksion ndaj imperializmit – por si reaksion ndaj idealeve dhe vlerave, institucioneve dhe sistemeve të sundimit, që janë imponuar nga perëndimorët.²⁴

Për Izetbegoviqin islami është rrugë jetësore, ndërsa epitetin nga "kundërshtarët" si "islamist" ai e lidh merininë e tij e hershme kur ishte pjesëtar i lëvizjes "Mladi Muslimani" (Myслиmanët e rinj). Ai mund të quhet "islamist" edhe për faktin se myslimanët boshnjakë i njoftonte me idetë e mendimtarëve islamikë. Ai një radhë kishte nënvizuar se "islami është i mirë, ndërsa myslimanët nuk po sillen mirë". Përmasa nacionaliste e Izetbegoviqit mund të

²⁰ Asaf Bayet, "Post-islamcılık siyasi islam'ın değişen yüzü", Litera Yayincılık, İstanbul, 2016, fq. 23

²¹ Po aty, fq. 27

²² Said, W. Edward, "Shtrembërimi i islamit", fq. 14, Logos-A, 2011

²³ Nexhat Ibrahim, Vepra 10, Logos-A, 2009, fq. 338

²⁴ Po aty, fq. 336.

shihet në fjalët e tij: ”Robër kurrë nuk do të bëhem!” Qëllimet e tij kanë qenë të lidhura ngushtë me popullin boshnjak; nacionalizmin e përshtati me islamizmin.²⁵ Sipas kësaj, , i bie që Izetbegoviqi ka jetuar mes dy idealizmave: nacional dhe fetar.

Aspekti nacional tek Izetbegoviqi vërehet qartë në ndërtimin e qëndrimeve të tij për boshnjakët, autonominë e shtetit të Bosnjë-Hercegovinës, rezistencën në luftën e përgjakshme katërvjeçare (1992-1995), në ndërtimin e institucioneve shtetërore pas pavarësisë. Politikisht, Izetbegoviqi duket të ketë qenë pragmatist-realist, ka vepruar sipas gjendjes faktike dhe parametrave politikë. Paralel me Kulenoviqt ‘ ‘ *se shteti islam nuk është i mundur pa shoqëri islame* ’ ’²⁶, është munduar të ndërtojë një shtet boshnjak në bazë të shoqërisë boshnjake.

Ta përmbledhim, koncepti ‘ ‘islamizëm’’ mbetet mes paragjytimeve dhe skepticizmave politikë, ideologjikë, kulturorë dhe sociale. Islami është fe, ndërsa *islamizmi* është ideologji, fjalë fleksibile, e ndryshueshëm, islami është formë hyjnore, ndërsa islamizmi kategori humane (njerëzore), *islami* është fjalë hyjnore nga Zoti dedikuar njerëzimit, , ndërsa *islamizmi*– reaksion i muslimanëve ndaj dominimit Perëndimit. .

²⁵Tarik Kulenoviç, *Islami politik*, 2012, fq.231

²⁶Po aty, 238

1.3. Gjeneza e Islamit politik

Rrënjët e islamizmit si ideologji moderne politike mund t'i gjejmë në shekullin XVIII, tek lëvizjet reformiste paramoderne – siç është vehabizmi”²⁷ Roy thotë se gjeneza e “islamit politik” shkon deri në fillim të viteve 1930, me formimin e dy lëvizjeve islame “Vëllazëria Myslimane” në Egjipt nga Hasan el-Benna dhe partia islame “Xhemaat-i Islami” nga Ebu’l-A’la el-Mevdudi. Sipas disa të tjerëve islamit politik ka nisur të zhvillohet kah fundi i viteve 1970.²⁸

Një tezë tjetër është ajo se “Islami politik” është produkt i fundit të shekullit XIX, rrjedhim i risistemimit të islamit në aspektin ideologjik. Sipas “Enciklopedisë Islame”, botim mbi 40 vëllime i Fondacionit Turk të Fesë (TDV), koncepti “islamizëm” si ideologji fetaro-politikeka lindur pak para shuarjes së Shtetit Osman, diku kah fundi i shekullit XIX, në kohën e Abdulhamidit II”.²⁹

Në kohën e Abdulhamidit II “islam politik” përfaqësohej nga shprehja “ittihad-i islam” (uniteti islamik). Sulltani në fjalë njihet promotor i islamizmit që idenë e transformoi në aksion. Atëbotë, islamizmi lindi si nevojë e bashkimit të myslimanëve si reaksion i kolonializmit”.³⁰

Se “islamit politik” daton nga fundi i shek. XIX theksojnë edhe Ibrahim dhe Pajaziti. Ky i fundit në fjalorin e tij të sociologjisë islamizmin e shpjegon si rrymë ideore të periudhës së fundit të shtetit osman, si ideologji që thotë se Islami është fe dhe sistem jetësor, një teori politike – sociale që plotëson nevojat e kohës dhe mendimet bashkëkohore, një fe e hapur ndaj zhvillimeve moderne, ndërsa përfundimi mund të ketë epërsi ndaj botës islame – por jo ndaj islamit dhe se myslimanët duhet të zhvillohen në sferat e ndryshme jetësore”.³¹

Nga ana tjetër, Izetbegoviqi në librin e tij “Problemet e rilindjes islame”, përpos që i trajton problemet e ringjalljes islame në botë, thekson se lëvizjet e para islame në botë datojnë nga fillimi të shekullit XX, duke dhënë si shembull “Lëvizjen Islame për liri) në

²⁷ Tarik Kulenović, “Islami politik”, 2012, fq. 143.

²⁸ Enes Kariq & Nusret Çançar, “Fundamentalizmi islam ç’është ky?” Logos-A, 2011, fq. 96

²⁹ Grup autorësh, “Islam Ansiklopedisi”, vëllimi 23, Stamboll, 2001, fq. 62-63.

³⁰ Po aty, fq. 470.

³¹ Ali Pajaziti, Fjalor i sociologjisë, botimi i dytë, 2017, fq. 275

*Indonezi të formuar në vitin 1912, lëvizja Muhammadiyah, Jong Islamieten Bong (Asociacioni i Rinisë Islame), themeluar më 1925, Lëvizja e Abdulkadirit në Algjeri*³². Izetbegović thekson se lëvizjet islame burojnë nga populli dhe si qëllim kanë pasurndryshimin radikal të sistemeve arsimore.

Shkaqet e lindjes së ‘‘islamit politik’’, si koncept ideor – aksionar, janë të shumta. Më zhbërjen e perandorive dhe hapjen errugës së modernizmit – për myslimanët nisi një fazë e kërkimit të ideologjisë politike që do të ishte koherente me vlera e tyre sublimë, shpirtërore, fetare-islame. Ndër shkaqet kryesore të lindjes së islamizmit përmenden *nevoja e shpëtimit të myslimanëve nga prapambetja arsimore, shkencore, sociale dhe teknologjike, humbja e statusit të elementit mbisundues në Shtetin Osman, frika nga devijimet dhe përçarjet që sollën këto ndryshime*³³.

Në atë kohë myslimanët kërkonin një rend të ri ideologjik, dëshironin të jenë pjesë e ndryshimeve dhe integriteteve shoqërore, sociale, politike, kulturore. Përpos këtyre, ishte edhe ideja e kërkimit të myslimanit të ri aktiv – një rilindje islame që do të ishte mbrojtje e myslimanëve nga kërcënimet e ndryshme perëndimore, të oksidentalizimit apo të perëndimizimit që perceptohej si një rrymë që tjetërsonte, që ia merrte frymën islamike botës islame. Pra, me një fjalë ‘‘islamistët’’ dëshironin që ta sfidojnë botën perëndimore në aspekt ideor dhe material. Ky koncept perceptohet edhe si nocion për t’iu përgjigjur sfidave të kohës. Idetë islamiste i aktualizuan islamistët në shumë sfera të ndryshme shoqërore.

Rilindja islame në botë solli me vete edhe ‘‘reformatorët islamistë’’, siç shprehet Kulenović. Këtë gjendje, autori turk Ali Köse, në librin e tij ‘‘Evropa dhe Islami’’, e ilustron kështu: ‘‘ në shekullin XIX, myslimanët nuk ishin të detyruar më të udhëtonin në Perëndim për t’i njohur evropianët, sepse ata tashmë ishin në hap me kohën ’’³⁴, pra e njohnin frymën perëndimore përmes refleksioneve të modernizmit në vendet e tyre.

Pak para formimit të shtetit modern turk, përveç nocionit ‘‘Ittihad-i Islam’’ të Abdulhamidit II, në vitin 1909 u formua edhe lëvizja islame ‘‘Ittihad-i Muhammedi Cemiyeti’’ (Shoqëria e Unitetit Muhamedan). Më vonë koncepti ‘‘islamizëm’’ në aspekt

³² Alija Izetbegović, *Vepra 2 - “ Problemet e rilindjes islame”*, Logos-A, 2013, fq.407.

³³ Po aty, fq.405-406

³⁴ Ali Köse, ‘‘ Evropa dhe Islami’’ ,Logos-A, 2015, fq.9

politik do të përjetojë ngritje me Nexhmettin Erbakanin dhe poetin e mirënjohur turk Nexhip Fazëll Kësakyrek me lëvizjen Büyük Doğu (Lindja e Madhe).

Myslimanët ballkanas detyrimisht ishin të ndikuar nga lëvizjet islame dhe aktivistët islamikë nëpër hemisferën arabe dhe jo-arabe. Kjo situatë më së miri mund të shihet nëpërmjet organizimeve, aktiviteteve kulturore dhe grupeve islame që filluan të marrin hovin e tyre pas viteve 90-ta të shekullit XX. Përndryshe, zanafilla e ‘‘islamit politik’’ në Ballkan ~~fillon me~~ është formacioni ‘‘ Mladi Muslimani’’ por kjo më shumë si lëvizje myslimane boshnjake kundër komunistëve, ndërsa në shtrirjen e saj strukturore apo politikisht është rrjedhojë e ndikimit të rrethit kulturor politik të Izetbegoviqit, jo vetëm për myslimanët boshnjakë por edhe ata shqiptarë.

1.4. Përfaqësuesit e islamit politik

Kolonializmi dhe pushtimi i tokave islame nga vendet ~~anglo-amerikane~~ ~~apo ndikimet politike të fuqive të mëdha~~ perëndimore gjatë fundshekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, ~~shquhet të jetë përbëjnë~~ katalizatorin ~~apo~~ shtytës ~~in~~ që i detyroi myslimanët e rinj intelektual të fillojnë aktivizimin e tyre shoqëror.

Islamistët konsiderojnë se shoqëria do të mund të jetë e islamizuar vetëm nëpërmjet aktivizimit social dhe politik. Është interesante se prijësit/përfaqësuesit e lëvizjeve islame nuk janë klerikë (me profesion hoxhallarë – përveç rastit të Iranit me Homejnin), shumica e tyre vijnë nga shtresa intelektuale, të rinj intelektualë që kanë kryer shkollimin nëpër vende perëndimore.

Formatted: Albanian (Albania)

Përfaqësuesit më të mëdhenj të konceptit “islam politik” janë: *Xhemaluddin el-Afgani, Muhamed Abduhu, Muhamed Reshid Rida, Hasan el-Benna, Ebu-l-A'la el-Mevdudi, Sejjid Kutubi, Muhamed Ikbali, Hasan et-Turabi, Rashid el-Gannushi, Nexhip Fazëll Kësakyreku, Nexhmettin Erbakani, Alija Izetbegoviqi, Rexhep Tajjip Erdogani, Tarik Ramadani, Metin Yuxseli, Nexhip Fazëll Kësakyreku* etj. Këta janë vetëm disa nga emrat që mund të cilësohen si promotorë të termit “ islam politik”, përfaqësues të mendimit islamist apo lëvizjeve islame. Të njëjtët njihen edhe si përfaqësues të *panislamizmit*, të lëvizjeve islame reformiste që angazhohen për mbrojtjen e myslimanëve dhe për vetëdijësimin e tyre për ta islamizuar jetën dhe veprën e tyre. Lëvizjet islame që u ngjyrosën me epitelin “ islam politik” janë “Vëllazëria Muslimane” themeluar Hasan el-Bennaja në Egjipt, “Xhemaat-i Islami” i Mevdudiut nga Pakistani, “ Milli Görüş”-i i udhëhequr nga Erbakani në Turqi, “Mladi Muslimani” në Bosnjë dhe Hercegovinë e të tjera më pak të dukshme në rrjedhat shoqërore.

Formatted: Font: Italic

Koncepti “islam politik” nuk është i njëjtë për të gjithë mendimtarët dhe prijësit e lëvizjeve dhe organizatave të ndryshme nëpër botë. Secili është munduar që islamizmit t’i japë frymën e kohës, vendit dhe rrethanave shoqërore.

Kulenoviq thotë se Afganiu, Abduhu dhe Rida janë flamurtarët e “islamit politik”. Sipas tij, këta mendimtarë mund të quhen edhe “protonacionalistë ose protoislamistë” nga –

shkaku se karakteristikë e përbashkët e tyre është tubimi rreth vetes i masave të vogla të pasuesve³⁵. Ata merren edhe si nismëtarët e luftëskundër kolonializmit nëpërmjet mendimit islam.

Ndryshe, “islamistët reformatorë” – Hasan el- Benna, Sejjid Kutubi dhe Mevdudiu për shumë intelektualë dhe mendimtarë islamist njihen si “ideatorët” kryesorë të rilindjes islame në botë që me shkrimet dhe publikimet e tyre bënë thirrje për rimëkëmbjen islame nëpër botë, përaktivizëm islamik shoqëroro-politik.

Në vazhdim do japim një pasqyrë të përfaqësuesve kryesorë të lëvizjeve islame apo islamiste:

Formatted: No underline

Xhemaluddin Afgani (1838 – 1897) – mendimtar dhe aktivist politik, i lindur në Iran. Afganiu është i idesë se duhet në mënyrë adekuate myslimanët t’iu përgjigjen kërkesave moderne. Ishte kundër okupimit britanik të tokave muslimane. Afganiu theksoi nevojën e reformave të brendshme dhe të vetëpërceptimit. Afganiu, që njihet si njëndër figurat e para reformiste politikisht aktive, thoshte se myslimanët duhet të modernizohen në mënyrën e vet. Sipas tij, islami është besim që manifestohet në veprim. Afganiu konsiderohet pioner i modernizmit islam.

Muhamed Abduhu (1849 – 1905) – nxënës i Xhemaluddin Afganiut. Njihet si arkitekt i modernizmit islamik, i pari që njohu nevojën e reformave dhe aktivizmit për të ndaluar shkatërrimin e shoqërisë. Reforma arsimore në Egjipt ishte një ndër synimet e Abduhusë. Bashkë me Afganiun botuan revistën “el-Urveh el-vuthka” (Lidhja e Fortë).

Mevdudi (1903-1979) – mendimtar reformator indo-pakistanez, themelues i organizatës islamike “Xhemaat-i Islami” me shtrirje strukturore nëpër shumë vende të botës islame. Mevdudiu ishte kundërshtar i përdorimit të dhunës në përkrahje të islamit. Arsimi për të ishte gur themeli për aktivizimin islam. Sipas Mevdudiut, shpëtimi i kulturës muslimane qëndronte në rimëkëmbjen dhe pastrimin e institucioneve dhe të praktikave islame. Autor i më shumë se 150 veprave. (disa nga veprat: “*Drejtë të kuptuarit të islamit*”, “*Kodifikimi i kushtetutës islame*”, “*Të kuptuarit e Kur’anit*”, “*Themelet morale të lëvizjes islame*” etj.

Formatted: No underline

³⁵Tarik Kulenovic, *Islami politik*, Logos-A, 2012, fq.143.

Hasan el-Benna (1906 – 1949) – themelues i organizatës më të madhe islamike në botë “Vllezëria Muslimane”. Kjo lëvizje njihet më shumë si lëvizje sociale, sesa politike. Qëllimi fillestar i lëvizjes ishte arsimimi. Benna ishte promotor i idesë së mesazhit islamik tek njerëzit. “Vëllezëria Muslimane” mbetet të jetë njëra ndër lëvizjet më të zëshme islame në botë duke pasur degët e saja nëpër shumë vende të botës islame, përfshirë edhe Ballkanin dhe troje shqiptare. Ndër veprat e tij të publikuara në (shqip janë: “20 parime për të kuptuar Islamin”, botim-Furkan ISM, 2011, libri-“ Si duhet ta kuptojmë islamin”, “ Kujtimet” – Vëllazëria Muslimane, “ Grave muslimane”).

Homejni (1902 -1989) – klerik shiit iranian, udhëheqës i Revolucionit Islamik të vitit 1979, ideolog i Republikës Islamike të Iranit. Kundërshtues i politikave shekullariste dhe perëndimore. Ndikimi i strategjisë së Homejnit në Iran, islamin, nga aspektet rituale ka transformuar në aspekte sociale, politike dhe kulturore islame.

Sejjid Kutub (1906-1966)- një ndër mendimtarët më të zëshëm të rilindjes islame në botën moderne. Sejjid Kutub ishte pjesëtar i lëvizjes islame “Vëllezëria Muslimane”. U burgos dhe u ekzekutua për për shkak aktivitetit të tij politik me ngjyrimet islame. Kutubi ishte për kthim të vlerat burimore të islamit, për çka cilësohet si fundamentalist. Ka shkruar mbi 20 vepra. (-“Shenja në Rrugë” Logos-A,1998; “ Ilustrimi artistik në Kur’an”, “ Jasini – për kthim dhe komentim” etj).

Formatted: Font: Not Italic

Hasan et-Turabi (1932-2016) – udhëheqës politik dhe islamist sudanez. Njëri ndër promotorët e lëvizjes islame “ Vëllezëria Muslimane” në Sudan. Përkrahës i kushtetutës islame nëpërmjet ‘ Frontit të Kartës Islamike’. Ideator që shteti i Sudanit të jetë shtet islamik. Autor i disa librave me konotacion fetar. Në gjuhën shqipe njihet me veprën “ Gruaja në Islam dhe në Shoqërinë Muslimane”, të botuar nga Logos-A në vitin 1994.

Formatted: Font: Italic

Nexhmettin Erbakan (1926-2011) – mendimtar dhe politikan turk. Udhëheqës i lëvizjes islamike turke “ Milli Görüş”. Themelues i disa partive politike –turke, me orientim neo-islamiste. Përkrahës i idesë dhe konceptit “Adil Düzen” (shqip: “ Rend i Drejtë”) – orvatja e rendit të ri shtetëror, dhënien fund të nepotizmit dhe bashkëpunim ndërmjet shtetit dhe shoqërisë. Ideator i organizatës islamike “D – 8 “. Veprat kryesore të Erbakanit janë: “ “Kauza ime” botimet-Botimet FLETA-Fleta,2018; “Rendi i drejtë ekonomik” (Logos-A, 1993), “Islami dhe Shkenca”, Një botë e re dhe rendi i drejtë”, “Grusht-shteti” etj.

Formatted: Font: Not Italic

Alija Izetbegović (1925-2003) – ish-lideri i Bosnje dhe Hercegovinës, mendimtar, luftëtar, politikan boshnjak. Pjesëtar i organizatës islamike rinore “ Mladi Muslimani”. I burgosur politik. Themelues i Partisë Politike të Muslimanëve në Bosnjë dhe Hercegovinë – SDA:– (Partia e Aksionit Demokratik). Islami për Izetbegovićin është sistem jetësor.³⁶

Mendimet e Afganiut, Mevdudit, Sejfid Kutubit, Hasan el-Bennasë, Turabiut, Erbakanit dhe Izetbegovićit kanë ndikuar shumë edhe tek popujt ballkanas, sidomos tek shqiptarët dhe boshnjakët. Kjo gjendje mund të vërtetohet nëpërmjet rimëkëmbjes së rinisë intelektuale myslimane shqiptare në Ballkan gjatë viteve 80-të apo fillim të viteve 1990-ta, kur intelektualët myslimanë shqiptarë filluan me admirim t’i përkthenin dhe botonin veprat e kolosëve islamikë. Organizatat islamike “ Vëllazëria Myslimane”, “ Milli Görüş”, “Mladi Muslimani” mund të konsiderohen si katalizatorë të vërtetë të rimëkëmbjes islame në komunitetet islame të Ballkanit. Vala studentore shqiptare që vajtën për të studiuar jashtë vendit, që u njoftuan për së afërmi me lëvizjet islame, është një faktor tjetër që ndikoi në ngjalljen e mendimit islam ndër shqiptarë.

• Shih: John L. Esposito, “*Fjalori i Oksfordit për Islamin*” & Ali Pajaziti, “*Fjalor i sociologjisë*” dhe Nexhat Ibrahim, “*Fjalori enciklopedik islam*” .

2.1. Jeta dhe Vepra e Alija Izetbegoviqit

“ Kush është indiferent ndaj Alisë, pas takimit me të, bëhet simpatizues, kushështë simpatizues bëhet tifoz. Nëse tashmë ka qenë tifoz, bëhet fanatik” janë fjalët e shkrimtarit boshnjak Abdullah Sidran për veprën dhe jetën e Alija Izetbegoviqit.

Alija Izetbegović u lind më 8 gusht 1925 në Bosanski Šamac, në shtëpinë nga e cila dukeshin dy lumenjtë më të mëdhenj të Bosnjës, “Bosna” dhe “Sava”. Në vitin 1928, për shkaqe ekonomike dhe sociale, së bashku me familjen e tij vendoset në Sarajevë. **Meqë Alija ishte djali më i madh në familje, e barti rolin kryesor për ruajtjen e familjes, ndërsa e ëma e Alisë do të bëhej krahu i djathtë i tij në përkushtimin ndaj fesë.** Shkollimin e mbaroi në “Gjimnazine Parë për Meshkuj” që njihej se shkollë “komuniste”. **Periodha rinore e Izetbegoviqit ishte e trazuar emocionalo-shpirtërisht për shkak të rrethanave shoqërore dhe politike, besimore dhe morale në shoqëri. Kjo gjendje bëri që Izetbegović të ndikohej tepër shumë nga ideologjitë dhe bindjet majtiste, — shoqërimi Shoqërimi dhe zhvillimi i arsimit me profesorë me bindje ideologjike komuniste dhe bashkëbisedimi i tij me komunistë, ndikuan që te Aliu 15-vjeçar të ngjallte dyshime mbi fenë islame, por më vonë u bë rilindas dhe bartës i proceseve politike-islame në Bosnje dhe në botë, duke qenë pjesëmarrës aktiv në frymën revolucionare islame që më vonë do të emërohej si Lëvizja e Muslimanëve të Rinj (Mladi Muslimani).** **Një periudhë bashkë me një grup të rinjsh myslimanësh — ka qenë pjesëmarrës aktiv edhe në aktivitetet e shoqatës “El-Hidaje” të udhëhequr nga hoxha dhe alimi sarajevas, Mehmed Hane Hanxhiq.** **Qysh në rini të tij Izetbegović ishte admirues dhe lexues i flakët i filozofisë perëndimore dhe lindore, në një moshë shumë të re u njoftuan me veprat e Hegelit, Spenglerit dhe Kantit.** Studimet universitare, Izetbegović i filloi në agronomi, ndërsa pas 3 vitesh ai e ndërpreu këtë drejtim, duke u transferuar për të studiuar drejtësi, drejtim të cilin e kreunë kohë rekorde, brenda dy viteve, në vitin 1956, ndërsa në vitin 1962 e dha edhe provimin e avokaturës. **Një pjesë të jetës së tij e ka kaluar duke punuar si këshilltar juridik**

nëpër insitucione të ndryshme. Gjatë kësaj periudhe të vështirë derisa në një rën anë përfundoi studimet e jurisprudencës-drejtësisë, në anën tjetër Izetbegoviqi nuk u ndal së shkruari dhe menduari mbi fenomenet dhe dukuritë e kohës: sistemi komunist, kapitalizmi, ideologjitë, feja, etj. Ai përkundër ~~trysisë dhe~~ shtypjeve të regjimit të atëhershëm komunist, vazhdoi të ~~t'i~~ jepte frymëzim intelektual rinisë myslimane, ku me shkrimet e tij publicistike kërkonte aktivizim të myslimanëve në Jugosllavi, ~~e që~~ në fillim të viteve 70-të të shekullit XX, doli në pah libri "Deklarata islame", një libër që bëri jehonë të madhe ~~para~~ te opinionit, sistemi ~~t~~-por edhe vet myslimanëve myslimanët. Alija Izetbegoviqi ishte i dënuar në dy raste politike: I pari në mars të vitit 1946 nën akuzë pjesëmarrjes në aktivitetet e organizatës islame "Mladi Muslimani", ku pas tre vitesh vuajti dënimi, në vitin 1949 u lirua nga burgu. Në vitet 80-ta të shekullit XX, klima më liberale në Jugosllavi krijoi kushte për aktivizim fetar, me ç'rast edhe Alija Izetbegoviqi bashkë me shokët e tij filluan ~~aktivizimin~~ lëvizjen e tyre. Ky aktivizim i Izetbegoviqit i ra në sy shtetit dhe burgosja e dytë për Alija Izetbegoviqin ndodhi në vitin 1983 në procesin e montuar gjyqësor të mbiquajtur "Procesi i Sarajevës" – ku së bashku me të dënim me burg morën edhe shumë shokë, miq dhe bashkëmendimtarë të tij. Alija në këtë proces u dënua për shkak të librit "Deklarata Islame" të shkruar në fillim të vitit 1970, dënimi i parë ishte 14 vjet burgim, që më pas u shkurtua në 12 dhe më pas në 9 vite. U lirua nga burgu në vitin 1988, duke përfunduar dënimin me 5 vjet e 8 muaj. Pas daljes nga burgu, në vitin 1989 Izetbegoviqi mori iniciativën për formimin e partisë politike "Srpske Demokratske Akcije (Partia e Aksionit Demokratik) dhe më 26 maj 1990, në kuvendin themelues të partisë, u zgjodh kryetar i saj. Partia e Aksionit Demokratik (PAD-SDA) në fillim shihej si parti e profilizua mbi parimet e rrethit kulturor-historik musliman (sidomos shihej si parti e rrethit kulturor të myslimanëve boshnjakë dhe shqiptarë të Jugosllavisë), mirëpo pas ndarjes së kufijve jugosllavë kjo parti u profilizua si parti nacionale boshnjake dhe e komunitetit boshnjak. Më 5 dhjetor të vitit 1990, SDA-ja si parti e re politike i fitoi zgjedhjet e para parlamentare në Bosnje dhe Hercegovinë, ndërsa Alija Izetbegoviqi u zgjodh kryetar i shtetit. Pas referendimit të suksesshëm të mbajtur më 1 mars të vitit 1992, Bosnja dhe Hercegovina shpalli pavarësinë e saj. Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, gjendja në BeH u përkeqësua, ku mes viteve 1992-1995 lufta kishte kapluar edhe Bosnje dhe Hercegovinën, ndërsa Izetbegoviqi përveç se ishte kryetar shteti, ishte edhe luftëtar në mbrojtje të kombit dhe fesë. Pas presioneve ndërkombëtare dhe vuajtjeve të mëdha që populli i tij po i përjetonte, në nëntor të vitit 1995, u detyrua të nënshkruaj marrëveshjen e Dejtonit për paqe që de fakto ndau Bosnjën dhe Hercegovinën. Në shtator 1996 ai u rizgjedh president i presidencës treanëtarësh të Bosnjës. Në korrik të vitit 2000, Izetbegoviqi shpalli vendimin e

Formatted: Albanian (Albania)

tij për dorëheqje nga posti i presidentit të Bosnjës. Shëndeti në njërën anë, mosha e shtyrë dhe më e rëndësishmja ashtu si ai u shpreh përcaktimi i komunitetit ndërkombëtarë të dobësoj esencën islame të Bosnjës.

Izetbegoviqi është fitues i Çmimit për të Drejtat e Njeriut i qytetit të Izmirit (1994), është dekoruar me medaljen kroate "Mbretëresha Katarina" (1995), më 1997, Doktor Nderi i Universitetit Marmara të Stambollit, Doktor Nderi i Universitetit të Riadit, Medaljen e Lirisë e Republikës së Turqisë, më 1998, Medaljen e Pavarësisë të Katarit dhe Kartën e Paqes të Ligës Ndërkombëtare Humaniste, shpërblimin e Forumit "Crans Montana" për promovimin e të drejtave të njeriut (1999). Ndërroi jetë më 19 tetor të vitit 2003 dhe u varros në varrezat e dëshmorëve në Kovaçi të Sarajevës³⁷.

Formatted: Albanian (Albania)

Idetë dhe veprat kryesore të Izetbegoviqit

Izetbegoviqinërininëetij të hershme ndjente mëdyshje për islamin si religjion. Ai këtë e pohon në *Kujtimet* e tij duke pohuar se ndikimi i rrethanave ku ishte shkolluar, bashkëjetesa me komunistët – dhe bindjet dhe propaganda e fuqishme e komunistëve bashkëbiseduese kishin shtyrë drejt ujërave të lëkundjes nga feja, gjendje kjo e “tronditjes fetare” që nuk kishte zgjatur më shumë se dy vjet. Faktorishtyts që e për afroi Izetbegoviqin me fenë islame ishte përkushtimi i nënës së tij ndaj fesë, fjalët e një gruaje të devotshme që e ndihmoi atë ta njohë islamin.

Izetbegoviqi qysh në moshë të re u njoftua me botën perëndimore dhe evropiane. Arriti t'i lexojë të gjitha veprat më të rëndësishme të filozofisë evropiane: Kantin, Sprenglerin, Hegelin, Spinozën të tjerë. Ky lexim e ka shtyrë Izetbegoviqin t'i vë ballë për ballë dy botëkuptimet: mendimin perëndimor dhe rimëkëmbjen islame. Islamin aktiv që do të realizonte rimëkëmbjen islame tek ai e ngjallën Ikballi, Mevdudi, el-Benna. Ndërkohë dinamizmin ideor ia mbanin gjallë librat e mendimtarëve dhe filozofëve perëndimorë. Në fakt Alija arriti të bëjë një gërshetim të mirë mes këtyre dy botëkuptimeve. Ai në Perëndim e mbronte Islamin, kurse në Lindje e mbronte Perëndimin, pa harruar se është musliman”³⁸

Mendimi ideor dhe zhvillimi intelektual i Izetbegoviqit është edhe si rezultat gjeografik, vetë

³⁷Shih: Nexhat Ibrahim, “Fjalor enciklopedik Islam”, Logos-A, 2017, fq.77-79 dhe TDV Islam Ansiklopedisi “Izzetbegović Alija”, vëllimi shtesë (turqisht:EK-1), Stamboll, 2016, fq. 687-689.

³⁸Alija Izetbegović, “Vepra 1”, Logos-A, 2013, fq.25

Alija jetoi dhe u zhvillua nën ndikimin e fuqishëm të Lindjes dhe Perëndimit. Sipas prof.dr. Ahmet Davutogllut (ish-kryeministër i Turqisë dhe njëherazi edhe autori i librit “Thellësia Strategjike”, botuar nga Logos-A në vitin 2010), ‘*Alija Izetbegović gjatë jetës së tij ishte dëshmitar i katër regjimeve të ndryshme: Ai jetoi në kohën mbretërisë dhe sistemit komunist, ishte dëshmitar i rrënimit të socializmit dhe në periudhën e presidencës së tij fitoi përvojë nga sistemi demokratik*’³⁹.

Botëkuptimi ideor i Izetbegoviçit ndërtohet mbi premisat e njeriut, moralit, besimit dhe islamit. Kjo gjendje më së miri mund të vërehet nëpërmjet shkrimeve të tij që autori sendërton mbi islamizmin. Në shkrimet e tij vërejmë dualizmin fetar dhe material. Sipas Izetbegoviçit islami është një sistem që ngërthen në vete edhe shpirtëroren por edhe materialen. Izetbegoviçi thotë se njeriu është i ndërtuar prej shpirtit dhe trupit, ashtu siç islami ka dy pole: materialen dhe fetaren. Nëse për Lindjen e rëndësishme është shpirtërorja, ndërsa për Perëndimin materia, atëherë Islami është fuqia që i bashkon këto dy pole: materien dhe shpirtin. Islami në botëkuptimin Izetbegoviçian perceptohet si “rugë e tretë” apo *third way*.

Sipas intelektualit turk Berat Sankaya, Izetbegoviçi si filozof dhe politikan, konceptet ÷ moral, drejtësi, demokraci dhe politik i percepton me këndvështrimin islam duke theksuar se islami është në qendër të këtij botëkuptimi⁴⁰.

Formatted: Font: Not Italic

Veprat e Izetbegoviçit trajtojnë sfidat e kohës, ngjarjet shoqërore, rimëkëmbjenislame, etikën, moralin, shkencën, politikën, tragjeditë historike, qytetërimin, fenë në përgjithësi, etj. Veprat e tij politike dhe fetare kërkojnë një emancipim më gjithëpërfshirës.

Sipas Izetbegoviçit, Islami është edhe ~~jetësim~~ koncept fetar por edhe shoqëror. Njëra ndër synimet themelore të Izetbegoviçit është edhe ideja e ri-zgjimit të islamit. Në idetë e Izetbegoviçit shohim se vet autori dëshiron një islam aktiv, ku dëshira për ndryshim sipas tij vjen vetëm me aktivitet. Islami dhe njeriu janë dy indikator që kanë fuqi për të bërë këtë ri-zgjim dhe ndryshim, një islam ku njeriu është në epiqendër të saj dhe një shoqëri ku islamin do ta merr si pikësynim. Këtë gjendje vet Izetbegoviçi e shpreh kështu: “*Nëse nuk ka Zot,*

³⁹ Ahmet Davutoğlu, “*Aliya Modeli ve Bosna’daki Liderlik Yapılanması*”, *Aksiyon*, nr.94, Stamboll, 1994, fq. 38-40.

⁴⁰ Berat Sarıkaya, “*Aliya Izetbegović’in düşünce dünyası ve inancını şekillendiren tarihsel arkaplan*”, *Turkish Studies – Comparative Religious Studies*, Volume 13/25, Fall 2018, fq. 402.

nuk ka as njeri”. Njeriu sipas tij ishte epiqendra edhe e jetës shpirtërore por edhe materiale. Përpos lirisë Izetbegović thoshte se njeriu ka edhe moral.

Njëra ndër shtyllat kryesore ku dallohet shkrimi i Izetbegovićian ishte edhe aktivizimi i islamit, ose një islam që do të jetë ri-gjeneruese. Në epiqendrën të këtij aktivizimi islam do të ishte njeriu. Sipas Izetbegovićit rimëkëmbja islame është obligim edhe njerëzor, por edhe moral. Aktivizimi islam nënkupton brendësinë shpirtërore të njeriut, moralen dhe shoqëroren. Edhe përkundër faktit se në tekstet e Izetbegovićit rreth ri-zgjimit shohim entuziazëm dhe shpresë, shpeshherë atë mund ta gjejmë edhe si ~~vet~~-kritikues për pasivitetin e myslimanëve nëpër botë. Ndryshe, islami aktiv tek shkrimet e Izetbegovićit nuk është e bazuar vetëm me aktivizim të myslimanëve boshnjakë apo të jetë aktivizim njënacional, njëfetar, tek Izetbegović shohim thirrje për aktivizim të islamit nga Indonezia deri në ~~Magrib~~ **Magreb**. Në shkrimet e tij, vërehet se autori iu kundërvihet qartë koncepteve të shteteve njënacionale, njëfetare apo njëpartiake. Alija Izetbegović, nuk shkruan vetëm për aktivizim të myslimanëve boshnjakë, por për aktivizim të islamit.

Veprat kryesore të Izetbegovićit

“Problemet e rilindjes islame” është një vepër me përmbledhje të shkrimeve, eseve publicistike mbi ringjalljen islame, tema ku me shkrimet e tij Izetbegović shtjellon rrugëtimin e një botëkuptimi revolucionar islam. Kjo vepër është shkruar gjatë viteve 70-ta të shekullit XX. Në këtë libër vërehet “trishtimi” i Izetbegovićit ndaj prapambetjes së aktivizimit islam në botë, kërkesa e tij gjallërimit të islamit.

“ Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit ” – është kryevepër, libri me të cilin Izetbegović ka shënuar emrin e vet në mesin e autorëve të mëdhenj rreth botëkuptimit islamik. Kjo vepër është përkthyer në shumë gjuhë botërore, anglisht, arabisht, turqisht, shqip etj.). Izetbegović këtë libër e ka shkruar qysh në moshë të re – thuhet se koncepti i parë i librit është shkruar në të 20-tat e autorit. Libri në fjalë ka karakter publicistik dhe në të Izetbegović shfaq idetë e veta të ndërthurura me inspirimin nga pikëpamjet e reformistëve islamikë anti-kolonialë si Mevdudi, Abduhu, Reshid Rida, Ikbali e të tjerë.

“*Deklarata islame*” – është një manifest politik i Izetbegoviqit nga perspektiva islame. Një program politik islam që shpjegon veprimin aksionar dhe strategjik që duhet të ndërmarrin myslimanët për rimëkëmbjen islame.

“*Ikja ime në liri*” (1983-1988). Në këtë libër autori publikon shkrimet e tij nga jeta disavjeçaree burgut në burgun e Foçës..

“*Kujtimet*” është një libër autobiografik i Alija Izetbegoviqit, siç shprehet vetë autori: “*kujtimet janë fragmente të jetës sime*”. Një udhëpërshkrim i Izetbegoviqit në kohërat e të “pakohëve”, në kohën e irracionalitetit, mes të keqes dhe të mirës, mes shpresës dhe anktheve tragjike, mes diplomacisë dhe luftës’. Vepra përveç jetëshkrimit ngërthen edhe biseda, opinione, fjalime etj.

“*Robër nuk do të bëhemi*” (Fjalime 1990-1995) përbën fjalimet dhe paraqitjet e Izetbegoviqit në kohërat më të vështira të popullit të tij dhe Ballkanit nga themelimi i SDA-së deri në fund të vitit 1995. Është një rezymë e ngjarjeve më tragjike të Bosnje- Hercegovinës, të kohës së përgjakshme kur Izetbegoviqi dhe populli i tij kërkonin lirinë dhe pavarësinë.

“*Ditët e paqes së ftohtë e të hidhur*” (1996-2003) janë fjalimet dhe publikimet e autorit nga koha e pasluftës, kur mendimtari në fjalë mendohej për ndërtimin e Bosnje- Hercegovinës si shtet i mirëfilltë, demokratik, sovran dhe autonom.

“*Në kufij të botëve*” (Deklarata, fjalime, porosi, letra (1990-2003)- është një sërë shënimesh të autorit gjatë dekadës më të rëndë për Ballkanin për fatin e kombit të tij. Një përshkrim i situatave dhe rrethanave që nga fillet e SDA-së, periudha së luftës së përgjakshme dhe gjenocidit mbi Bosnjën dhe myslimanët, deri te kërkimi i paqes shpirtërore dhe të ardhmes së “padefinuar” të myslimanëve dhe Bosnjës në kontekstin ndërkombëtarë.⁴¹

Analiza e mendimtarëve, intelektualëve dhe personaliteteve të shquar politike dhe shoqërore të vendit dhe botërorë mbi jetën dhe veprat e Alija Izetbegoviqit është argumenti më i fortë se kush ka qenë Izetbegoviqi. Alija mbetet të simboli i rezistencës së myslimanëve

⁴¹Kompleti i veprave të Alija Izetbegoviqit në origjinal është publikuar në vitin 2005 nga SHB “OKO” e Sarajevës, ndërsa në gjuhën shqipe ka ardhur në vitin 2013 nga SH.B. “Logos-A” nga Shkupi në 5 vëllime: “Vepra 1 – Jeta, Vepra dhe Personaliteti i Alija Izetbegoviqit; “Vepra 2: Islami ndërmjet lindjes dhe perëndimit / Problemet e rilindjes islame dhe Deklarata Islame dhe Deklarata Islame; “Vepra 3 – Ikja ime në liri (shënime nga burgu 1983-1988); “Vepra 4 – Kujtime (shënime autobiografike)” dhe “Vepra 5: “Robër nuk do të bëhemi” (shënime 1990 -1995) / Ditët e paqes së ftohtë e të hidhur (Fjalime 1996-2003) dhe Në kufij të botëve (Deklarata, fjalime, porosi, letra 1990-2003).”

Formatted: Albanian (Albania)

Formatted: Albanian (Albania)

ballkanas në fundshekullin e XX_ku sipas të shkrimtarit të mirënjohur turk tashmë të ndjerë, Akif Emre, Izetbegovići mbetet të jetë erudit i kohës. Bota islame, e veçanërisht bota turke Alija Izetbegovićin e njeh duke ia dhënë epitetin ~~Princi i Dijes~~ Mbreti i Urtë (turqisht: Bilge Kral). U orvat që të mbijetonte Jugosllavia, kërkonte pavarësinë e shtetit boshnjak. Politika për Izetbegovićin ishte detyrim dhe përgjegjësi morale para Zotit dhe njerëzimit. Feja ishte përgjegjësi. Islamit e perceptonte si rrugëtim jetësor. Nëpërmjet fesë dhe politikës u mundua që të vendosë rend të ri shoqëror. Jetoi me bindje dhe krejt optimizëm për të ardhmen e vendit dhe shoqërisë muslimane. Ishte kritik ndaj “islamit klasik ritual”, fenë e zbërthente në bazë të esencës së saj mbinatyrore. Kjo vërehet shpesh në bisedat e tij me miq hoxhallarë, me të cilët çdoherë bisedonte për aktivizimin e islamit dhe zbërthimin e tij përtej ritualeve fetare. Izetbegović, nuk ishte teolog, por admironte islam aktiv. Ndoshta edhe kjo ishte njëra ndër arsyt kryesore, pse ai merr epitetin “islamist”.

Izetbegović ka qenë një optimist i madh, edhe përkundër pabarazisë në asete luftarake gjatë luftës 1992-1995, gjenocidit ndaj popullit musliman, kur sipas kishte humbur jetën çdo i 10-ti banor i këtij vendi, ngulmonte në krijimin e një shteti qytetar dhe demokratik. Ishte lider që dinte t’i kontrollojë krizat shtetërore, ishte njeri që me kreativitetin e tij arriti të bëhet edhe ushtar, edhe burrështetas, edhe ideator por edhe ideolog i politikës shtetërore, gjithmonë në qëllime të mira universale.⁴²

Formatted: Albanian (Albania)

⁴²Fikret Muslimovic & Selmo Cikotic, “*Mislilac i drzavnik – Alija Izetbegovic*”, botimi: Muzej “Alija Izetbegovic”, Sarajevo, 2016, fq.11

2.2. Islami politik në Ish- Jugosllavi (vitet 1990)

Formatted: German (Germany)

Zanafilla e islamit politik në ish-Jugosllavi lidhet me lëvizjen e të rinjve myslimanë të Bosnjë dhe Hercegovinës “ Mladi Muslimani ” (Myslimanët e Rinj). Izetbegović, në librin “ *Kujtimet* ” thotë se roli i organizatës apo lëvizjes myslimane “ Myslimanët e Rinj ” të formuar në fillim të 40-tave të shekullit XX ishte tepër i rëndësishëm në aktivizimin e islamit tek shoqëritë me popullatë myslimane. Sipas tij “ Myslimanët e Rinj ” ishin formuar dhe aktivizuar si koncept shoqëror kundër dy ideologjive: kundër fashizmit (Hitlerit) dhe kundër komunizmit (Stalinit), ndërsa roli i kësaj organizate ishte aktivizimi i islamit – si mendim i gjallë që mund të modernizohej duke e ruajtur esencën e saj⁴³

Islami politik në federatën ish-Jugosllave për myslimanët e Ballkanit, filloi t’i japë frytë e vetenë fillim të viteve 80-të të shekullit XX. Profesori universitar Fikret Karçiç thotë se mëkëmbja e islamit tek myslimanët e Ballkanit filloi të shfaqet në këto fusha: “ *rindërtimi dhe ndërtimi i xhamive* (hapja e xhamisë Et’hem Beut në Tiranë – viti 1990, ndërtimi dhe rindërtimi i xhamive në qytetet dhe fshatrat e Bosnjë dhe Hercegovinës etj), *veprimtaria botuese, kultura politike dhe organizatat, arsimimi, përdorimi i simboleve shoqërore islame dhe shfaqja e institucioneve islame* ”⁴⁴

Në aspektin politik aktivizimi i myslimanëve të Ballkanit filloi menjëherë pas shpërbërjes së Jugosllavisë, kur në vitin 1990, në skenën politike u shfaq Partia e Aksionit Demokratik (SDA). SDA-ja filloi të shihej si forcë e rezistencës dhe ri-islamizimit të myslimanëve të Jugosllavisë, jo vetëm boshnjakë por edhe të etnive tjera islame në vend, ku shihej qartë se kjo lëvizje politike filloi të merr trajtën e saj organizative edhe në vende tjera të Ballkanit, si në Sanxhak, Kosovë, Maqedoni, Kroaci etj. Koncepti i saj politik ishte “ bashkimi politik i myslimanëve të Jugosllavisë ” **apo siç pretendohet të thuhet në deklaratat e para të partisë se njëri ndër qëllimet e SDA-së ishte grumbullimi i shoqërisë së rrethit**

⁴³ Alija Izetbegović, “ *Kujtimet* ”, botimi: AKEA-Kosovë, 2008, fq.27

⁴⁴ Fikret Karçiç, “ *Myslimanët e Ballkanit: “Çështja lindore në shek. XX”* ”, ALSAR-Tiranë, 2016, fq.122.

kulturor mysliman nën një ombrellë politike⁴⁵. SDA-ja në simbolet e saja partiake shfaqte islamizmin “ flamuri i gjelbër me gjysmëhënë”, ndërsa asnjëherë nuk ka potencuar se do ta islamizonte shtetin apo se do të vendoste sistemin sheriatik në vend. Këtë gjë e vërtetojmë edhe te deklaratat e mëposhtme të Izetbegoviqit: “ *Unë nuk dua republikë islame, dëshiroj që Islami të ruhet në këtë pjesë të botës, i pëlqeu kjo dikujt ose nuk i pëlqeu* ”⁴⁶

Formatted: Albanian (Albania)

Emri i Izetbegoviqit në opinionin shqiptar u bë i njohur në vitet e tetëdhjeta, kur shkrimet e tij botoheshin në gjuhën shqipe me pseudonimin L.S.B: (L)ejla -(S)abina – (B)akir, me emrat e tre fëmijëve të tij⁴⁷.

Në artikullimin politik të SDA-së, si koncept politiko-kulturor për myslimanët e ish-Jugosllavisë, rol të rëndësishëm kishin edhe myslimanët e rinj shqiptarë të këtyre trojeve, studentët shqiptarë që kanë studiuar në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Turqi (gjatë viteve 80-të dhe 90-të, të shekullit XX), intelektualët e rinj myslimanë shqiptarë nga Kosova dhe Maqedonia. Profesori universitar Pajaziti këtë frymë integruese shoqërore e përshkruan si: “ *Islam(izm)i i frymëzuar nga Sarajeva, fryma e Izetbegoviqit* ”⁴⁸ Shihet qartë se kjo frymë intelektuale shqiptare izetbegoviqiane, ka luajtur një rol tepër të rëndësishëm në artikullimin politik të PAD-it në trojet shqiptare, veçanërisht në Maqedoni dhe Kosovë. Bartësit e këtij projekti politik, ishin dy miqtë e afërt të Alija Izetbegoviqit, intelektualët shqiptarë: Ismail Bardhi nga Maqedonia dhe Nexhat Ibrahim i nga Kosova. Fryma izetbegoviqiane tek shoqëria shqiptare në Jugosllavdepërtonte nëpërmjet dy intelektualëve shqiptarë të shkolluar në Sarajevë, Nexhat Ibrahim si bartës i projektit të SDA-së për Kosovë dhe Ismail Bardhi si promotor i idesë politike të SDA-së për Maqedoni.

Roli i këtyre dy intelektualëve shqiptarë tek formimi politik i PAD-it vërehet shumë qartë edhe nëpërmjet takimeve të shpeshta, bisedimeve dhe analizave të detajuara që janë zhvilluar mes qendrës së PAD-it në Sarajevë, konkretisht vetë Izetbegoviqit, me Nexhat Ibrahim dhe Ismail Bardhin. Profesori Bardhi në shkrimin e tij “ Alija Izetbegoviq – shehid/shahid (dëshmor/dëshmitar) i kohës”, verifikon këto fakte me fjalët: “ *Takimet tona ishin më të shpeshta, ku temat e bisedës vazhdimisht ishin kultura e muslimanëve, reforma racionale fetare në shoqërinë muslimane, afrimi vëllazëror mes shqiptarëve dhe*

⁴⁵Po aty, fq.121

⁴⁶Alija Izetbegovic, *Odabrani govori, pisma, izjave, intervjui*, Zagreb: Prvo muslimansko dionicko drustvo, 1995, fq. 57.

⁴⁷Nexhat Ibrahim, “*Vepra 1*”, Logos-A, 2009, fq.213

⁴⁸Ali Pajaziti, “*Islamët shqiptarë – trendet, lëvizjet, aktorët e rinj islamikë në albanosferë në 25 vitet e tranzicionit: Një vështrim sociologjik*”, Samizdat, Shkup -2 018, fq.38.

Formatted: Albanian (Albania)

boshnjakëve... , bashkëpunimi i tillë me Izetbegoviqin na detyroi edhe ne të mendojmë dhe të punojmë për aktivizimin e myslimanëve shqiptarë tek ne’⁴⁹Vetë Izetbegoviqi ka qenë shumë i interesuar për gjendjen e islamit në trojet shqiptare. Ai “nuk bënte asnjë udhëtim nëpër qendra rajonale apo botërore, e të mos pyet për informacione të freskëta për gjendjen fetare, ekonomike, politike dhe kulturore në Kosovë dhe më gjerë’⁵⁰

Se Izetbegoviqi ishte i afërt me shqiptarët dhe kishte interesim të posaçëm për popullin shqiptar, vërtetohet nga fakti se programi politik i Partisë së Aksionit Demokratikku njëra ndër pikat programore kishte të bënte me çështjen e Kosovës.

⁴⁹ Alija Izetbegović, “Vepra 1”, Logos-A, 2013, fq.48.

⁵⁰ Nexhat Ibrahim, “Vepra 1”, 2009, fq.216

2.3. SDA (Partia e Aksionit Demokratik)

Fundi i viteve 80-ta dhe fillimi i viteve 90-ta të shekullit XX ishin paralajmëruesi i destabilizimit dhe trazirave që ndodhën vitet në vijim. Jugosllavia ishte para falimentimit të saj, ndërsa myslimanët e atij shteti kërkonin statusin e tyre brenda sistemit të ri pluralist.

Në sistemin e ri pluralist të ish-shteteve jugosllave, edhe në Bosnjë filluan të paraqiten dhe formohen parti të reja politike, serbët jugosllav formuan Partinë Demokratike Serbe (SDS), kroatët – Bashkësinë Demokratike Kroate, ndërsa myslimanët në krye me Izetbegovićin më 27 mars të vitit 1990 e formuan Partinë e Aksionit. Atë ditë në konferencën për shtyp u lexua deklarata, nënshkruar të së cilës ishin dyzet qytetarë për çka edhe u emërtua si “Komunikata e dyzet vetave”

Në “komunikatën e dyzet vetave” shkruhej kështu: *“të ballafaquar me krizën e shoqërisë jugosllave, që nuk është vetëm ekonomike, por edhe politike dhe morale, të interesuar për ruajtjen e Jugosllavisë si bashkësi e kombeve dhe kombësive, për vazhdim të proceseve demokratike në drejtim të lirisë, shtetit modern dhe juridik, për të realizuar interesat e përbashkëta të gjithë qytetarëve, por edhe interesat e veçanta të grupit kulturor historik musliman, kemi vendosur të iniciojmë themelimin e Partisë Aksionit Demokratik”*.⁵¹

Përpos kësaj, deklarata e konferencës për themelimin e SDA-së, kishte shpallur edhe 16 parimet bazë të programit politik të SDA-së:

1) Partia e Aksionit Demokratik është lidhje politike e qytetarëve të Jugosllavisë, të cilët bëjnë pjesë në grupin kulturor historik musliman, bashkë me qytetarët që i përfaqëojnë qëllimet dhe programin e partisë.

⁵¹ Alija Izetbegović, “Kujtimet”, AKEA-Kosovë, 2008, fq. 78.

2) SDA në kuadër të konkurrencës demokratike do të angazhohet për realizimin e programit dhe synimeve të saja me pjesëmarrje në zgjedhje dhe pjesëmarrje në punën e organeve përfaqësuese.

3) Demokracia është njëndër përcaktimet tona programore; me demokraci nënkuptojmë qeverisjen e popujve me ligje të drejta, liri dhe barazi të qytetarëve, pa dallime fetare dhe kombëtare, gjinie apo race.

4) Kërkojmë qeveri demokratike – anulimin e monopolit të një partie dhe themelimin e sistemit partiak ku parlamenti federal duhet të jetë i përbërë prej dy dhomave: dhomës së qytetarëve dhe dhomës së kombeve.

5) Demokracia duhet të perceptohet si parim i barazisë së plotë të popujve të mëdhenj dhe të vegjël, të drejtave fetare dhe të drejta për pakicat kombëtare.

6) Angazhohemi për ruajtjen e Jugosllavisë si bashkësi e lirë e popujve, respektivisht si union i shteteve në kufijtë e sotëm federalë .

7) SDA-ja do të ngjallë vetëdijen nacionale boshnjake-hercegovase të myslimanëve si popull autokton; do të angazhohemi për ruajtjen e Bosnjë – Hercegovinës si shtet i përbashkët i myslimanëve, serbëve dhe kroatëve.

8) Qëllimi – interesi ynë tjetër ka të bëjë me krahinën e Kosovës. Për këtë arsye kërkojmë demokraci për popullin shqiptar, përmbajmë dhe besojmë në opsionin jugosllav për zgjidhjen e krizës në Kosovë.

9) SDA-ja do të angazhohet edhe për zhvillimin e arsimit cilësor dhe si prioritet të saj ka zhvillimin e arsimit dhe shkollimit nëpër të gjitha shkallët, ku arsimi fillor të jetë i detyrueshëm, pa pagesë dhe gjithëpërfshirës.

10) Liria është e drejta themelore njerëzore. SDA do të angazhohet për liri të plotë të gjitha religjioneve në Jugosllavi dhe autonomi të plotë të bashkësive fetare. Do të angazhohemi për ndërtim të papenguar të objekteve fetare, qasje në mediet informative (radio, TV etj.) për bashkësitë fetare, për pranimi të festave kryesore fetare si ditë jopune për një kategori të caktuar fetare, ndërsa në mjediset e një shumice fetare si festë shtetërore. Do të angazhohemi edhe për ushqimin në ushtri, spitale dhe burgje në përputhje me dispozitat fetare për qytetarët.

11) SDA-ja përkrah reformat ekonomike në rindërtimin e ekonomisë popullore, pronën private e shohim si garanci të lirisë së veçantë të qytetarëve, ndërsa bujqësia për vendin tonë ka rëndësi të madhe në zhvillimin e vendit, toka punuese të mbrohet me ligj.

12) Do të kërkojmë mbrojtje të veçantë të femrave të papunësuar – nënave, me orar të zvogëluar pune.

13) SDA-ja u kushton rëndësi të veçantë vlerave morale dhe politike të familjes. Familja është një ndër faktorët e rëndësishëm për edukimin e individit dhe krijimin e kohezionit shoqëror brenda çdo bashkësie. Interesimi ynë do të jetë edhe parandalimi i sëmundjeve të vartësisë (alkoolizmi, narkomania etj).

14) Angazhohemi për ndryshimin e Kodit penal (material dhe procedural), për harmonizimin e tij me të drejtat e njeriut dhe konventat ndërkombëtare që janë pranuar dhe ratifikuar nga Jugosllavia. Kërkojmë lirim të gjithë të burgosurve politikë.

15) Përkrahim zhvillimin e kulturës ekologjike dhe të gjitha masave të aktiviteteve për mbrojtjen e ambientit jetësor. Anëtarët e partisë duhet të jenë pjesëmarrës dhe anëtarë të lëvizjeve ekologjike në mjediset ku jetojnë.

16) Partia jonë konsiderohet si pjesë përbërëse e frontit demokratik. SDA-nuk do të bashkëpunojë me partitë që punojnë për shkatërrimin e Jugosllavisë, për ndryshimin e kufijve të saj, apo që do të propagandojë jotolerancë dhe shovinizëm.⁵²

Në bazë të programit politik të SDA-së, shihet qartë se partia e Izetbegoviqit nuk ishte parti e themeluar mbi parimet bazë të shariatit islamik. SDA-ja nuk kishte kërkesa që ta islamizojë shtetin apo shtetet përreth saj. Partia e Aksionit Demokratik ishte formuar mbi bazat e mendimit të lirë politik, ishte një grupim politik që nuk i përkiste shkollës së sistemit komunist. SDA-ja për qëllim kishte ruajtjen e kohezionit shoqëror mes bashkësive të ndryshme në vend, ku liria, demokratizimi, barazia, zhvillimi ekonomik, social dhe politik shiheshin si shtylla bazë të partisë.

Partia e Aksionit Demokratik – nuk është parti islame, por ajo shihet si një organizim politik i myslimanëve të Jugosllavisë në rrethin kulturor dhe historik. Qëllimi bazë i SDA-së ishte bashkimi dhe organizimi politik i popujve myslimanë në Jugosllavi, veçanërisht boshnjakëve dhe shqiptarëve, ndërsa organizimi politik i SDA-së nuk ishte vetëm në Bosnje

⁵² Alija Izetbegović, "Vepra 4", Logos-A, 2013, fq. 73-79.

dhe Hercegovinë, por ajo filloi të shpërndahet dhe të organizohet edhe në Sarxhak, Kroaci, Maqedoni, Austri, Amerikë etj.

Sipas profesorit ar Bejtulla Demiri⁵³ *Islami në aspekt politik për SDA-në më shumë shihej si nocion kulturor, sesa ideologjik*,⁵³ SDA-ja ishte një lëvizje e myslimanëve që si bazë programore kishte lirinë, drejtësinë, demokratizimin, zhvillimin ekonomik dhe social të popujve ballkanas. Nuk mund të identifikohet si parti e themeluar mbi aspirata radikale islame.

Aspekti islam i SDA-së mund të shihet në simbole të partisë: *“ flamuri i gjelbër në gjysmëhënë dhe zambak në sfond të bardhë ”*, por kjo sipas Izetbegoviqit ishte në një mënyrë për të reflektuar identitetin e popullit boshnjak. Disa herë ngjyrosja me petkun “islam” të SDA-së shihet edhe nga fjalimet, tubimet dhe përdorimi i shprehjeve islame në publik, siç mund të jenë disa deklarata dhe fjalime të Izetbegoviqit nëpër tubime të ndryshme. I këtij karakteri ka qenë fjalimi në tubimin themelues të partisë, të cilin Izetbegoviqi e filloi me shprehjen islame : *Bismillah*(Në emër të Zotit!), Lidhur me këtë rast në “ Kujtimet ” e tij shprehet kështu: “ fjalimin e fillova me *bismillah*, për dy arsye: e para sepse sinqerisht e kam kërkuar ndihmën e Famëlartit; dhe e dyta, si akt i lirisë fetare e sinjal i qartë i mosbindjes ndaj regjimit⁵⁴

Izetbegoviqi ishte politikan mysliman, që nuk e dëshironte shkatërrimin e Jugosllavisë, ai kërkonte ndërrimin e pushtetit dhe sistemit politik nëpërmjet proceseve demokratike, ku bashkësitë e ndryshme fetare dhe kombëtare do të jetonin në kohezion shoqëror mes vete. Izetbegoviqi në asnjë rast nuk ka dëshiruar islamizimin apo krijimin e një shteti islam brenda Jugosllavisë, ndërsa kjo më së miri mund të vërehet në fjalimet e tij menjëherë pas themelimit dhe strukturimit të SDA-së në shtetet jugosllave. Si shembull mund të marrim dy fjalimet e tij: a) fjalimi në Kuvendin themelues të partisë të mbajtur më 26.05.1990 në Sarajevë ku, mes tjerash ka thënë: *“Bosnja është edhe muslimane, edhe serbe, edhe kroate.”* dhe b) fjalimi parazgjedhor në tubimin e SDA-së në Velika Klladushë të mbajtur më 15.09.1990, ku ka pohuar: se *“ Ideali ynë është republika qytetare, Bosnja dhe Hercegovina si republikë qytetare, por jo republikë islame dhe as republikë socialiste.*

⁵³ Bejtulla Demiri, “Islam i politika – politichko iskustvo na muslimanite”; Logos-A, Skopje, 2009, str. 207.

⁵⁴ Alija Izetbegović, “Kujtimet”, 2008, fq. 87

*Republikë qytetare dhe e lirë, ky është përcaktimi përfundimtar i popullit mysliman''.*⁵⁵Këtë objektiv apo strategji vërteton edhe programi politik i SDA-së.

Ndërkohë Partia e Aksionit Demokratik kishte filluar të shtrihej në gjitha trojet jugosllave, me të gjitha kapacitetet e saj intelektuale dhe politike. Zhvillimi i shpejtë dhe i fuqishëm i SDA-së në Jugosllavi solli me vete edhepërçarjet dhe fraksionet brendapartiake. Përçarja e parë ndodhi menjëherë pas themelimit të partisë, konkretisht u shfaqën divergjenca mes krahut të Izetbegoviqit dhe krahut të emigrantit të mirënjohur boshnjak, themeluesit të Institutit Bosnjak në Zvicër, Adil Zulfikarpashiq. Shkaku i përçarjes mes Izetbegoviqit dhe Zulfikarpashiqit ishte fryma e partisë:Zulfikarpashiqi ishte i mendimit që të identiteti i SDA-së të njësohej mepopullin boshnjak, ndërsa Izetbegoviqi ishte që e njëjta të kishte edhe karakter islamik.⁵⁶

Në zgjedhjet e para pluraliste të mbajtura më 18 nëntor 1990 në Bosnje dhe Hercegovinë, partia e Alija Izetbegoviqit, ishte fituesja e zgjedhjeve demokratike: nga 240 vende deputetësh në Kuvendin e Republikës së Bosnjë-Hercegovinës, Partia e Aksionit Demokratik –SDA-ja, fitoi 84 mandate, ndërsa prej 7 anëtarëve të Kryesisë, tre ishin të SDA-së.

Roli i SDA-së ishte i fuqishëm edhe në mobilizimin dhe sensibilizimin e shoqërisë myslimane në vend. Kjo part mundi ta sensibilizojë opinionin në ruajtjen e kohezionit shoqëror mes etnive të ndryshme në Jugosllavi. Përveç kësaj, nëpërmjet fjalimeve dhe pjesëmarrjes së Izetbegoviqit nëpër konferenca të rëndësishme nëpër botë mundua të trasojë rrugëtimin politik dhe shoqëror të myslimanëve. Nëpër fjalimet dhe takimet e shpeshta që ka mbajtur Izetbegoviqi me liderët rajonalë dhe botërorë, shihet qartë se lideri boshnjak ka dashur që Jugosllavia të mos shkatërrohej, ndërsa tentimi i tij i fundit për Jugosllavinë ka qenë gjatë takimeve që ka realizuar me presidentin e atëhershëm të Maqedonisë, Kiro Gligorov, presidentin e Kroacisë, Franjo Tugjman dhe liderin kriminel serb Slobodan Millosheviq.

SDA-ja, përpos tentativave për ruajtjen e kohezionit multi-kulturor në shoqëri, ka pasur edhe agjendëpër mbrojtjen e Bosnjë- Hercegovinës: pak para fillimit të luftës së përgjakshme (1992-1995), Partia e Aksionit Demokratik formoi Këshillin Nacional për Mbrojtje, Lidhjen Patriotike dhe më vonë edhe Armatën e Bosnjë dhe Hercegovinës.

⁵⁵Alija Izetbegoviq, *“Vepra 5”*, Logos-A, Shkup, fq. 32.

⁵⁶Alija Izetbegoviq, *“Kujtimet”*, AKEA-Kosovë,2008, fq.86.

Roli i Partisë së Aksionit Demokratik, në harmonizimin dhe zhvillimin e paqes multi-kulturore në Bosnjë dhe Hercegovinë, zë një vend të veçantë. Lufta e përgjakshme që zgjati më shumë se 3 vjet e gjysmë në Bosnje dhe Hercegovinë, ndërmjet myslimanëve boshnjakë, serbëve dhe kroatëve, përfundoi me nënshkrimin e Marrëveshjes së Dejtonit më 21 nëntor të vitit 1995, firmosur nga lideri boshnjak Alija Izetbegović, presidenti i atëhershëm i Kroacisë, Tugjman dhe presidentit të Serbisë, Millosheviq. Me këtë marrëveshje shteti u nda në dy federata: në parim 51 për qind i takoi Federatës së BeH-së, 49 për qind Federatës Serbe dhe si entitet i tretë, distrikti Bërçko. Marrëveshja e Dejtonit solli paqe të përkohshme në BeH, duke e përfunduar luftën e përgjakshme. Kjo marrëveshje edhe sot e kësaj dite është aktuale për Bosnjë dhe Hercegovinën. Rol dhe përpjekje shumë të rëndësishme për përfundimin e luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë kanë luajtur edhe përfaqësuesit e SDA-së Alija Izetbegović, Haris Silajxhiq etj.

Formatted: Albanian (Albania)

SDA-ja gjatë historikut të saj ka përjetuar disa përçarje tjera brenda saj: partia DNZ BiH (Demokratska Narodna Zajednica-Bashkësia Demokratike Popullore) e themeluar nga Fikret Abdiq në vitin 1993, partia SBiH (Stranka za Bosnu i Hercegovinu-Përtia për BeH) e themeluar nga Haris Silajxhiq menjëherë pas përfundimit të luftës, në vitin 1996, partia A-SDA (Stranka Demokratske Aktivnosti-Partia e Aktivitetit Demokratik) e themeluar në vitin 2008 nga Nermin Ogresheviq.

Alija Izetbegović u tërhoq nga jeta politike në vitin 2001, ndërsa në vend të tij si udhëheqës partie u emërua Sulejman Tihiq. Pas vdekjes së Tihiqit në vitin 2014, kryetar i Partisë së Aksionit Demokratik është emëruar djali i të ndjerit Alija Izetbegović, Bakir Izetbegović. Sipas analistit politik turk Mehmet Uğur Ekinci, “aktualisht SDA-ja është parti politike që përkrah integrimin e vendit në NATO dhe BE. Në aspekt të politikës së jashtme kjo parti mundohet të krijoj marrëdhënie të mira me SHBA-në dhe Turqinë”⁵⁷ Aktualisht SDA-ja është anëtare e Unionit Ndërkombëtar Demokratik (IDU) dhe Partisë Popullore Europiane (EPP).⁵⁸

Alija Izetbegović mund të shihet si politikan musliman, si islamist, i cili kishte për qëllim rimëkëmbjen e popujve myslimanë në Jugosllavi (-rimëkëmbje me ngritje shpirtërore morale dhe politike, gjithsesi rimëkëmbja synonte aktivizim intelektual dhe politik të myslimanëve. Izetbegović ishte një politikan aktiv që islamin e shihte si sistem jetësor, ku

⁵⁷ Mehmet U. Ekinci, “Bosna-Hersek Siyasetini anlama kılavuzu”, SETA - Ankara, 2014, fq. 48

⁵⁸ Parti politike europiane që përfshin në vete parti – dhe jo individë- konservatore dhe liberal-konservatore.

Formatted: Albanian (Albania)

moralit dhe sistemi i drejtë shoqëror do të ishin të drejtë për të gjithë shoqëritë, edhe për myslimanët edhe për jomyslimanët.

Formatted: Albanian (Albania)

2.4. Sanxhak

Partia e Aksionit Demokratik si parti e rrethit kulturor dhe historik të myslimanëve në Jugosllavishihej si lëvizje popullore myslimane e cila fuqishëm filloi të strukturohet edhe në degëjashtë BeH-së, siç janë: Serbi-Sanxhak, Mal të Zi, Maqedoni, Kosovë etj.

Strukturimi politik i SDA-së në Sanxhak në fillim ka qenë e organizuar nën Këshillin Nacional Mysliman për Sanxhak, pjesëtar të stë cilit kanë qenë një grup i myslimanëve boshnjakë të Sanxhakut si Sulejman Ugljajin (themelues dhe kryetar aktual i SDA për degën e Sanxhakut), myftiu i Sanxhakut Muamer Zukorliq etj.

Kuvendi themelues i SDA-së për Sanxhak është mbajtur më 29 korrik 1990 në Novi Pazar, ku kanë marrë pjesë edhe aktivistë të SDA-së për Kosovë ⁵⁹

Që nga themelimi i SDA-së për Sanxhak, kryetar i saj është një nga themeluesit kryesorë të partisë, Sulejman Ugljajin. Gjatë luftës së përgjakshme në BeH, për shkak të afërsisë që Ugljajin kishte me qendrën e SDA-së në Sarajevëudetyrua ta lëshojë vendin e tij, me ç'rast fillon edhe dobësimi politik i SDA-së në këtë rajon.

Sikurse partia amë edhe SDA e Sanxhakut ka pësuar përçarje të brendshme: një nga themeluesit e partisë Rasim Ljaljiq vendosi të largohet nga SDA-ja dhe të formojë SDP-në (Socialdemokratska Partija Srbije-Partia Socialdemokratike e Serbisë).⁶⁰

Sulejman Ugljajin gjatë viteve 2004-2008 ka qenë kryetar i komunës së Novi Pazarit, ndërsa gjatë viteve 2008-2014 ka ushtruar detyrën emnistit pa resor në qeverinë e Serbisë.

⁵⁹Nexhat Ibrahim, "Vepra 1", 2009, Shkup, fq.230

⁶⁰Mehmet U Ekinci, "Sırbistan Siyasetini anlama kılavuzu", SETA - Ankara, 2014, fq.62

SDA-ja e Sanxhakut si synim programor ka sensibilizimin dhe zhvillimin arsimor, ekonomik dhe social të pakicave boshnjake në vend. Ajo lufton për më shumë të drejta të myslimanëve të Sanxhakut, ngjashëm me të drejtat që i gëzojnë serbët që jetojnë në shtetin e Kosovës.⁶¹ SDA-ja e Sanxhakut, njësoj si qendra e saj në Sarajevë, kërkon që rajoni i tyre të integrohet në NATO dhe BE.

SDA si parti politike me frymë pro-islame dhe ideologji konservatore, parti e qendrës së djathtë, ndër vite është transformuar nga parti e bashkimit të rrethit kulturor-historik musliman në parti nacionale boshnjake. Kjo gjendje më së miri mund të vërehet edhe në transformimin e strukturave të saja në degët e Kosovës dhe të Maqedonisë: sot kjo parti në këto shtete më tepër është parti politike e boshnjakëve sesa e myslimanëve.

Formatted: Albanian (Albania)

⁶¹Po aty, 63

2.5. Kosovë

Partia e Aksionit Demokratik si lëvizje popullore myslimane në Jugosllavi, realizoi shtrirjen e saj strukturore edhe në Kosovë.

Përgatitjet e saj për themelimin e degës partiake në Kosovë ikishte filluar me mikun e afërt të Alija Izetbegoviqit, islamologun e mirënjohur nga Prizreni, Nexhat Ibrahim. Profesor Ibrahim nga Prizreni, mund të cilësohet si ideologu dhe nismëtari i themelimit të SDA-së për Kosovën në fillim vitet e 90-ta të shekullit XX.

Në “ Kujtimet” e tij për themelimin e SDA-së në Kosovë, Nexhat Ibrahim thotë kështu: “ Kisha përkrahjen e qendrës në Sarajevë dhe të vetë Izetbegoviqit. Në emër të Këshillit Nismëtar për themelimin e SDA-së në Kosovë, bashkëme shokët dhe aktivistët filluam t’itërhiqim njerëzit nëpër qytete e fshatra, nga gjithë Kosova” ⁶²Angazhimi i Ibrahimit bashkë me shokët dhe aktivistët e tjerë të PAD-it ka qenë fryma demokratike për Kosovën, një alternativë kosovare, “respektimi i subjektivitetit të plotë të Kosovës”⁶³.

Kjo parti nuk u formua për një periudhë të caktuar nga shkak i burgosjes dhe gjyqimit të Nexhat Ibrahimit nga shteti serb në fund të vitit 19928 vjet e 1 ditë burg. Dega e SDA-së për Kosovë, më vonë do të themelohet nga boshnjakët e Kosovës. PAD-i sot është aktive në skenën politike kosovare, si parti e minoriteteve në Kosovë, ajo angazhohet për sensibilizimin, zhvillimin kulturor dhe social të minoritetit boshnjak në Kosovë. Ajo më shumë perceptohet si parti nacionale boshnjake e Kosovës, sesa si parti e rrethit kulturor-historik të shqiptarëve dhe boshnjakëve.

⁶²Nexhat Ibrahim, “ Vepra 1”, 2009, fq.230

⁶³Po aty.

Aktualisht në skenën politike kosovare ka disa parti politike me orientim fetar apo përfaqësuesetë islamit politik: Partisë së Drejtësisë (Lëvizja për Drejtësi), LISBA dhe ‘‘Fjala’’, që kapin 3 % të votave të përgjithshme të Kosovës.⁶⁴

2.6. Maqedoni

Partia e Aksionit Demokratik e udhëhequr nga lideri boshnjak Izetbegović në periudhën në fjalë kishte filluar të frymojë edhe në Maqedoni, me ç’rast intelektualët e rinj shqiptarë të këtyre trojeve, miqtë e afërt të Izetbegovićit, kishin nisur përgatitjet e tyre për formimin e opsionit të ri politik në Maqedoni. Njëri ndër bartësit kryesor të SDA-së për Maqedoni, promotori i idesë politike të kësaj partie, ishte intelektual i ri nga Maqedonia, Ismail Bardhi, i shkolluar në Sarajevë.

Kuvendi themelues i PAD-it për Maqedoni, është mbajtur më 8 gusht 1990 në Tetovë, me ç’rast partia u pagëzua si Partia e Aksionit Demokratik – Rruga Islame. Sipas profesor Ibrahimit, pjesëmarrës në këtë tubim nga Bosnja ishte edhe vet lideri boshnjak, Alija Izetbegović, Hasan Çengiqi, Adil Zulfikarpashiqi. Fjalimi përshëndetës i Izetbegovićit me rastin e themelimit të PAD-it të Maqedonisë ishte kritikuar ashpër nga gazetaret maqedonase dhe si pasojë, regjistrimi i partisë ishte vonuar për 4 vjet’’.⁶⁵

Partia e Aksionit Demokratik – Rruga Islame, si parti politike në Maqedoni regjistrua në qershor të vitit 1992. Pas problemeve juridike dhe administrative, kjo parti më vonë do të ndryshojë emrin në Partia e Aksionit Demokratik – Rruga e Vërtetë.

PAD-i në Maqedoni shihej si degë e SDA-së qendrore dhe organizim politikparaqitej si parti e qytetarëve të Maqedonisë që i përkasin rrethit kulturor-historik islam. Sipas profesorit Etem Aziri ‘‘ *PAD – Rruga e Vërtetë është parti që në qendër të saj ka njeriun, që angazhohet për shtet sovran të Maqedonisë dhe liri të plotë dhe të barabartë mes bashkësive dhe popujve; nëpër forumet e kësaj partie vërehet përdorimi i barabartë i gjuhës*

⁶⁴ Ali Pajaziti, ‘‘Islamët shqiptarë – trendet..’’, 2018, fq.57

⁶⁵ Nexhat Ibrahim, ‘‘Vepra 1’’, 2009, fq.234

*shqipe, maqedonase dhe turke. PAD-i është parti politike që angazhohet për lirinë e religjionit në vend, pranimin e festave fetare, autonomi të bashkësive fetare''.*⁶⁶

Partia e Aksionit Demokratik – Rruga Islame, ishte pjesëmarrëse në zgjedhjet parlamentare të tetorit të vitit 1994. Koalicioni mes Partisë Demokratike të Turqve dhe Partisë Aksionit Demokratik – Rruga Islame arriti të fitoj një ulëse në parlamentin e Republikës së Maqedonisë.⁶⁷ Kryetar i PAD-it për Maqedoni ka qenë inxhinieri tetovar Kenan Mazllami. Ndryshe, pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 1994 SDA-ja ipushoi aktivitetet e veta politike.

Formatted: Not Highlight

Aktualisht, në skenën politike të Maqedonisë, është aktive partia boshnjake SDA-Stranka Demokratske Akcije, parti e cila nuk ka ngjyrimë islame, e profilizuar për komunitetin boshnjak dhe që angazhohet për të drejtat e qytetarëve boshnjakë në vend.

⁶⁶ Etem Aziri, “Partitë politike dhe demokracia”, Logos-A: 2004, fq. 67-68,.

⁶⁷ Etem Aziri, “Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni”, Logos-A, 2004, fq. 185

Formatted: Albanian (Albania)

Kapitulli III – Librat fetaro-politike të Izetbegoviqit

3.1. Analizë e librave fetaro-politikë të Izetbegoviqit

Veprat e politikanit, filozofit dhe mendimtarit të shquar boshnjak Alija Izetbegović, konsiderohen ndër gjurmët më thelbësore që një mendimtar ballkanas ka dhënë lidhurme dashurinë ndaj fesë. Izetbegović në shkrimet e tij fletë për liritë religjioze, lirinë, humanizmin, drejtësinë, shoqërinë, islamin aktiv e subjekte të ngjashme. Veprat e tij janë një konglomerat botëkuptimesh sociologjike, filozofike, politiko-shoqërore dhe ese apo shkrime të islamistikës Bota islame Izetbegovićin e ka njohur nëpërmjet veprave “*Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit*”, “*Deklaratës islame*” dhe “*Problemet e rilindjes islame*”.

Në shkrimet apo esetë Izetbegovićit vërejmë Islamin e gjallë, islamin aktiv që synon unitetin musliman. Për Izetbegovićin rilindja islame është esenca veprimtarisë që do të shpienë një rend ku kjo fe do jetë aktive në të gjitha sferat shoqëro-politike. Shkrimet më revolucionare, kryengritëse, frymëzuese dhe të zjarra për thirrje të rimëkëmbjes islame mund t'i gjejmë në esetë –shkrimet publicistike të tij të botuara në veprat: “*Problemet e rilindjes islame*”, “*Deklarata islame*” ndërsa tek libri “*Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit*” shohim Izetbegovićin mendimtar duke analizuar përplasjet ideologjike mes lindjes dhe perëndimit. Sipas tij, Islami, që “është më tepër se religjion”, shmang përplasjet ideologjike dhe religjioze.

Shkrimet fetare të Izetbegovićit nuk ishin teologjike sepse vetë autori nuk ishte teolog. Në përsiatjet e tij islamistike autori është kritikues i “ashpër” i teologëve klasikë apo i hoxhallarëve, i perceptimit të islamit vetëm si xhami apo tempull.

Islamizmi apo islami politik i Izetbegoviqit më së miri shpërfaqet veprat ‘ ‘ *Problemet e rilindjes islame*’ ’ dhe ‘ ‘ *Deklarata islame*’ ’ mund të shohim. Nëpërmjet këtyre dy librave tregon hapur rrugëtimin që duhet ta bëjnë myslimanët bashkëkohorë, duke theksuar që në fillim se motivi kryesor i tij është: ‘ ‘ islamizimi i myslimanëve’ ’. Konceptet mbi të cilat janë të ndërtuara këto dy libra janë: ‘ ‘ rimëkëmbja shoqërore islame, rilindja islame, shteti ideal islam, revolucion i islam, kultura arsimore dhe morale e myslimanëve, shoqëria islame, pushteti islam etj.

Me rimëkëmbjen shoqërore Izetbegoviq nënkupton rendin e ri islam, ‘ ‘ shtetin ideal islam’ ’ ku myslimanët do të edukonin gjenerata të reja të shkolluara me edukim fetar e moral. Dëshirën për ringjallje islame e ilustron kështu: ‘ ‘ *çdo mysliman është i ftuar të bëhet pjesëmarrës aktiv i rilindjes islame*’ Sipas tij lëvizjet islame burojnë nga populli, dhe nëse çdo gjë që buron nga populli del fitues, atëherë sipas Izetbegoviqit, *fitues në këtë botë do të jetë islami*⁶⁸. Koncepti i islamit tek Izetbegoviq nuk ishte teologjik, nuk bazohej në citate nga Kur’ani; autori islamit e shihte si koncept gjithëpërfshirës shoqëroro-politik. Në shkrimet e tij Izetbegoviq vazhdimisht kërkonte rrugëdalje nga stanjacioni apo dekadencia islame drejt revitalizimit të islamit zhvillues dhe aktiv. Sipas tij *islami është ideologji, ndërsa pan-islamizmi politikë e tij*⁶⁹. Motivi i aktivizimit shoqëror islam – ringjalljes islame për Izetbegoviqin rridhte nga reformistët modernistë islamikë si Muhammed Ikbali, Reshid Rida, Hasan el-Benna, Sejjid Kutub, Meududi etj.

Në veprën ‘ ‘ *Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit*’ ’ shihet përsiatja dhe përpjekja e Izetbegoviqit mbi religjionet dhe kundërshtimet ideologjike. Në përplasjen ideologjike-religjioze të Krishterizmit dhe Hebraizmit, pozicioni i Islamit shihet si ndërmjetësues, sintezë dhe rrugë e mesme që kërkon t’i bashkojë këto teza. Izetbegoviq në këtë vepër shkruan për ‘ ‘ fenë, religjionin, artin, moralin, filozofin, sociologjinë, politikën’ ’, tenton që të argumentojë se Islami është rruga që në çdo sferë shoqërore jep fryte dhe është shtegdalja e vetme e botës moderne. Këtu gjithashtu mund të vërejmë edhe kritikën që jep Indaj gjendjes së myslimanëve të shekullit XX. Për Izetbegoviqin islami nënkupton zhvillim, aksion dhe ringjallje – faktor ndërmjetësues mes përplasjeve lindje-perëndim.

Izetbegoviq konceptin e gjerë të islamit si nocion shoqëroro-politik, e thekson edhe nëpërmjet metodës dualiste duke i definuar 5 shtyllat themelore të fesë islame: *shehadeti*,

⁶⁸Alia Izetbegović, “Vepra 2”, 2013, fq.412

⁶⁹Po aty, 437

namazi, zekati, agjërimi dhe haxhxi. Sipas tij, islami është sistem i ‘‘unitetit bipolar’’:⁷⁰ ‘‘namazi- lutja islame, është lutje – pastërti dhe përpjekje fizike-shoqërore, ai nuk bëhet pa abdest-pastërti. Namazi fiton edhe dimensionin shoqëror; me xhemat futemi në opinion. Xhamia është vendi ku tubohemi ndërsa xhumaja ‘‘tendencë shoqërore’’ e namazit (proces i socializmit të lutjes). Xhumaja është namazi qytetar ose politik.’’⁷⁰ Sipas Izetbegoviqit, dhënia e zekatit – përqindjes obligative të pasurisë për të varfërit ka edhe përmasën fetare dhe atë shoqërore, ndërsa Haxhi është tubimi i myslimanëve të botës në një vend, tubim i madh politik.’’⁷¹. Kjo gjendje tek Izetbegoviqi përshkruhet edhe si kalim i islamit nga koncepti ummetik, ‘‘bashkësi e pastër shpirtërore’’ në ‘‘bashkësi shpirtërore-shoqërore-politike’’. Politika nënkupton formën më të lartë të organizimit dhe shprehjes së Islamit.

Dy konceptet në të cilat mund të vërejmë islam politik të Izetbegoviqit në shkrim janë ‘‘Islami ka marksizmin e vet’’ dhe ‘‘socializëm islam’’. Izetbegoviqi nëpërmjet këtyre dy maksimave dëshiron të dëshmojë se Islami është sistem shoqëror që bartë mbi vete edhe teori por edhe revolucion – zhvillim.

Veprimtaria fetaro-politike e Izetbegoviqit mund të analizohet apo ndahet në dy periudha kohore: e periudhës së sistemit komunist dhe ajo e periudhës së sistemit pluralist. Në veprimtarinë fetaro-politike të periudhës së sistemit komunist shohim një Izetbegoviq të zjarrtë, revolucionar, aktivist islamik i cili nëpërmjet shkrimeve të tij ‘‘kërkon rizgjim islam. Në periudhën pluraliste shohim një Izetbegoviq që duke e ruajtur epitetin politikan musliman, mundohet që ta shpëtojë atdheun e tij. Në fjalimet e tij politike - pluraliste, Izetbegoviqi shprehet për një ideal më shekullar, *republika qytetare, jo republikë islame, qytetare, e barabartë për të gjithë*’’. Në fjalimin mbajtur në Konferencën Islamike në Teheran më 11.12.1997 është shprehur se ‘‘islami është më i miri – kjo është e vërteta, por ne nuk jemi më të mirë’’⁷².

Shkrimet para viteve 90-ta tthejnë ‘‘islamin politik’’, ndërsa pas viteve 90-ta shkrimet dhe fjalimet politike të tij më tepër përmbajnë nënvizojnë barazinë-demokracinë-shtetin qytetar. Shkurt, Izetbegoviqi shkruante islamikisht, ndërsa vepronte politikisht.

⁷⁰ Alija Izetbegoviqi, ‘‘Islami ndërmjet lindjes dhe perëndimit’’, Logos-A, 2009, fq. 196-197,

⁷¹ Po aty, fq. 197.

⁷² Izetbegoviqi, Alija. ‘‘Vepra 5’’, 2013, fq. 357.

3.2. Deklarata Islame

Formatted: Albanian (Albania)

“*Deklarata Islame*” është manifesti politik islam i Izetbegoviqit, të cilin autori e ka shkruar kah fundi i viteve 60-ta të shekullit XX. Që në fillim Alija Izetbegoviqi na shpjegon se manifesti politik i tij ka për qëllim islamizimin e popujve myslimanë në botë.

Me islamizimin e myslimanëve Izetbegoviqi nënkupton përfundimin e dekadencës dhe stagnimit shekullor të myslimanëve, transformimin e menjëhershëm të muslimanëve nga pasiviteti shekullor në aktivizim shoqëror, ose siç shprehet vet ai, për *krijimtë bashkësisë unike islame prej Marokut deri në Indonezi*. Deklarata islame nuk është manifest politik i popullit dhe përkatësisë myslimane boshnjake, por është manifest i dedikuar myslimanëve në botë, ku detyrimisht kërkohet rimëkëmbja dhe gjetja e alternativës për aktivizim të islamit si koncept shoqëroro-politik. *Me fjalë të tjera Izetbegoviqi me Deklaratën Islame ishte një ummetist par-excellance.*

Formatted: Font: Italic

Formatted: Font: Italic

Ndryshe, Izetbegoviqi, përpos që është entuziast, reformist, idealist dhe revolucionar me deklaratën e tij islame, ai gjithashtu është edhe kritik i ashpër i muslimanëve dhe “heshtjes” islame në botë. Ai është kritik i “ashpër” i hoxhallarëve dhe teologëve klasikë, duke theksuar se islami nuk është vetëm religjion i xhamive apo objekteve për rituale, por është agjenci aktive sociale.

Formatted: Albanian (Albania)

Izetbegoviqi në “*Deklaratë Islame*” si pengesë të rimëkëmbjes islame i sheh **konservatorët** dhe **modernistët**: të parët e tërheqin islamit në të kaluarën, ndërsa të dytët ia përgatisin ardhmërinë e huaj.⁷³ Problemi esencial i prapambetjes apo dobësisë së

⁷³ Alija Izetbegoviqi, “*Vepra 2*” – pjesa: *Deklarata Islame*, Logos-A, 2013, fq. 421,.

myslimanëve nuk qëndron tek të tjerët, por tek stagnimi i mendimit islam, – tek mungesa e inteligjencës islame. Popujt myslimanë i cilëson si të robëruar, të paarsimuar, dhe si bashkësi e ndarë, duke theksuar se rrugëdalja nga kjo prapambetje është në krijimin e inteligjencës së re, mendimit të ri islam që do të ndërtojë rendin e ri islam në botë.

Rendi i ri islam sipas Izetbegoviqit ndërtohet mbi dy shtylla kryesore: *shoqëria islame* dhe *pushteti islam*. Izetbegoviqi rendin islam e *sheh si gjendje shoqërore ku muslimani është në harmoni të plotë me mjedisin e vet*⁷⁴, ndërsa shoqëria islame përbëhet nga bashkësia e myslimanëve **apo grupimi i myslimanëve në një ombrellë mbi qëllime dhe synime të njëjta fetaro-politike**. Në këtë drejtim, për avancimin e muslimanëve duhet lëvizje politike: historia nuk njihet asnjë lëvizje të mirëfilltë islame, e cila nuk ka qenë lëvizje politike.

Në “*Deklaratën islame*” – islami shihet si rend integral: islami nuk është vetëm religjion, është sistem shoqëror-politik, ekonomik e social. *Organizimi politik, ekonomik, social, kulturor, uniteti i myslimanëve, barazia, arsimimi, liria e ndërgjegjes, edukata, shteti islam, familja*, janë koncepte dhe definicione fundamentale mbi të cilat Izetbegoviqi mundohet ta shpjegojë konceptin e rendit dhe shoqërisë islame. Sipas Izetbegoviqit rimëkëmbja islame duhet të frymëzohet nga:

- a) kthimi tek burimet kur’anore, burimet vetjake materiale dhe shpirtërore,
- b) sendërtimi i harmonisë shoqërore dhe bashkësisë si koncept i unitetit të myslimanëve dhe
- c) zhvillimit ritmik, efikas dhe shpejtë të arsimit dhe industrializimit të shoqërisë myslimane⁷⁵.

Tubimi i myslimanëve në një bashkësi, të gjithë myslimanëve dhe të gjitha bashkësive myslimane në botë, apo krijimi i federatës islame nga Maroku deri në Indonezi për Izetbegoviqin nënkupton panislamizim. Unitetin e bashkësive islame nëpër botë Izetbegoviqi e interpreton si lëvizje edhe shoqërore por edhe moralo-emocionale.

Në këtë libër përpos asaj se si duhet të shihet shteti ideal islam apo rendi islam, Izetbegoviqi gjshkruan edhe për problemet me të cilat ballafaqohet rilindja islame apo zgjimi islam gjatë viteve 60-70 të shekullit XX. Ndërkohë shpjegon nëse rilindja islame është

⁷⁴Po aty, fq. 431.

⁷⁵Po aty, fq. 449

revolucion fetar apo politik. Izetbegoviqi islamin e interpreton duke e krahasuar mebotëkuptimet e kristianizmit dhe hebraizmit dhe të dy sistemeve shoqërore, kapitalizmit dhe socializmit.

Libri “Deklarata islame” e Alija Izetbegoviqit mbetet njëra nga programet themelore të rimëkëmbjes islame gjatë fundit të shekullit XX. Ky libër – si thirrje për rizgjim islam është deklaratesui *generis drejtuar* myslimanëve të botës. Është pikërisht libri “Deklarata islame”, që u bë shkak i burgosjes së dytë të Alija Izetbegoviqit, në procesi e montuar politik “Procesi i Sarajevës” në vitin 1983, me ç’rast autori u dënua me 14 vjet burg, duke u akuzuar për “fundamentalizëm islamik”.

Deklarata islame në gjuhën shqipe me propozimin e vet autorit është titulluar *Islami sot dhe nesër*.

3.3. Islami ndërmjet lindjes dhe perëndimit

Vepra “ *Islami ndërmjet lindjes dhe perëndimit* ” është veprakryesore e Izetbegoviqka bërë emër në korniza ndërkombëtare. Sipas disa të dhënave, konceptin e parë të kësaj vepre Izetbegoviqit e ka shkruar në të njëzetat e tij, ndërsa është në bazë të të dhënave, argumenteve, ngjarjeve dhe bibliografisë së përdorur, duket se është kompletuar kah vitet 1970-1980 të shekullit XX. “ *Islami ndërmjet lindjes dhe perëndimit* ” nuk është libër me karakter teologjik, e as Izetbegoviqi nuk është teolog. Libri në fjalë, i shkruar në vrullin e përplasjeve ideologjike gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, në vete është krahasim i islamit me botëkuptimin perëndimor dhe atë lindor.

Vepra është e ndarë në **dy pjesë**: *pjesa e parë* trajton çështjen e religjionit në kuptim më të gjerë, ndërsa *pjesa e dytë* i kushtohet islamit – si koncept përtej religjioz. Që në fillim autori thekson se mbi botën janë tri botëkuptime integrale: *religjioz*, *materialist* dhe *islamik*.⁷⁶ Botëkuptimi *religjioz* nënkupton Perëndimin /kapitalizmin/ Krishterizmin, botëkuptimi *materialist* nënkupton Lindjen/socializmi-materializmin/Hebraizmin (Judaizmin), ndërsa botëkuptimi *islamik* është sintezë dhe sinkronizim i dy botëkuptimeve të ndryshme apo pozicioneve kundërshtuese (religjionit dhe materializmit apo Krishterizmit dhe Hebraizmit). Botëkuptimi islamik ka fuqinë që t'i bashkojë apo të jetë urë lidhëse e dy botëkuptimeve të përmendura. Ndryshe, figurativisht botëkuptimi islamik i Izetbegoviqit mund paraqitet kështu: Krishterizëm + Hebraizëm (Judaizëm) = Islam. Izetbegoviqi islamin e percepton si diçka më shumë se religjioni, apo si një entitet tejreligjioz, si botëkuptim të kësaj bote, por edhe të botës tjetër.

⁷⁶Alija Izetbegović, “ *Islami ndërmjet lindjes dhe perëndimit*”, Logos-A, 2009, fq.9.

Në ~~tek Islamin~~ ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, të Alija Izetbegoviqit shohim një lidhëse të shpirtit dhe materies, e cila emërtohet ~~me si~~ islam. Njeriu si qenie mbetet ~~të jetë~~ epiqendra më ~~kuptimplotë-kuptimplotë~~ tek Izetbegoviqi. Sipas ~~Alija Izetbegoviqit~~ tij, fuqia e njeriut buron nga liria e tij, ndërsa këtë liri njeriu e ka fituar vetëm me Fuqinë e Zotit.

Në këtë libër Izetbegoviqi vendos theks të veçantë në paralajmërimin e rilindjes islame. "Islamin e vërtetë" autori e përshkruan me gjendjen e muslimanëve mes shekujve XIX dhe XX. Në pikëpamjet e tij filozofike dhe politike, Islami ballafaqohet ~~kundruall~~ sistemeve të atëhershme sistemet komuniste dhe socialiste, ~~gjersa Izetbegoviq në këtë~~ vepër shkruan edhe mbi gjendjen dhe trendet e atëhershme konkurruese të ndikuara edhe si në aspektin ideologjik, social dhe politik.

Filozofia e Izetbegoviqit është *shkencore, religjioze dhe me karakter dualist*. Në të ai iu referohet filozofëve dhe mendimtarëve perëndimor si Oswald Spengleri, Albert Camus, Heideggerit, Jean Paul Sartre etj, por edhe Muhammed Iballit, Sejjid Kutubit, Sejjid Amir Aliut etj. Përkaj këtij dualizmi filozofik dhe krahasues mes filozofëve perëndimorë dhe rilindësve islamistë, në ~~vepër-veprën~~ "Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit" të Izetbegoviqit gjejmë edhe temat dhe esetë e shkruara me karakter të dualizmit funksional, si p.sh. "Moralit dhe utopia", "Arti dhe religjioni", "Religjioni dhe revolucionit". Sipas Izetbegoviqit mesazhi i këtij veprimi krahasues është "islami i vërtetë" apo siç thotë vetë autori Islami si rrugë e mesme. Thënë ndryshe, nëse në këtë vepër "Lindja" nënkupton Lindjen socialiste dhe "Perëndimi" do të thotë Perëndimi kapitalist, atëherë i bie që "Islami i vërtetë" është po ky Islam që perceptohet si "rrugë e tretë" — ~~third way~~, në mesin e përplasjeve ideologjike Lindje-versus-Perëndim. Me fjalë të tjera, ndarja bipolare e botës në përplasjen ideologjike ~~lindje-lindje-perëndim-perëndim~~, e shpreh pozicionin e islamit si ndërmjetësues dhe sintezë e ~~këtyre dytë kësaj përplasjevepërplasjeje~~.

Vepra është religjioze por jo edhe teologjike. Izetbegoviqi nëpërmjet karakterit religjioz mundohet që t'i analizojë, inkorporojë, trajtojë dallimet dhe përplasjet ideologjike ndërmjet dy botëkuptimeve religjioze: Krishterizmit dhe Hebraizmit. Sipas tij, Islami është që entitet që bashkon religjionin dhe materializmin. Sipas Izetbegoviqit, ~~pozicioni i~~ Islamit është sintetizues dhe unitet i "religjionit dhe materializmit". Islami është një proces që ~~përmes~~ këtij procesi ~~nxitetnxit~~ zhvillimin ~~i saj~~. Islami nuk është ideologji, kjo fe është përtej religjioze, ~~mbase ka edhe~~ një fuqi të veçantë ri-gjeneruese dhe zhvilluese. Këtë situatë mund ta gjejmë edhe në formën ilustruese tek vepra e Izetbegoviqit, si p.sh. materializmi

(trupi) + religjioni (vetëdija) = islami (njeriu) apo materializmi (tatimi) + religjioni (lëmosha) = islami (zekati).

Në faqet e kësaj vepre madhështore, mendimtari i madh çështjeve mundohet t'iu gjejë zgjidhje islame. Zgjidhjen islame ~~vet-autori~~-e sheh edhe tek fuqia e islamit. Sipas tij Islami çdoherë do të dalë triumfues përballë Krishterimit dhe Hebraizmit, shkaku se në Islam nuk kemi dogmë apo hierarki, përpos Zotit të Fuqishëm. Pikërisht për këtë qëllim islami asnjëherë nuk mund të kthehet në diktaturë, sepse qëllimi i islamit është ~~ta fitojë~~-fitorja e njerëzimit~~njerëzimit~~. Liria e njeriut dhe morali i tij, mund të ~~fitohet~~-fitohen vetëm me fuqinë e Zotit. Alija Izetbegović thotë se në dualizmin shpirt-materie fiton *rruga e tretë* që quhet islam. Izetbegović thotë se islami filloi si mistikë, ndërsa më pastaj ~~u përpos u zhvillua~~ si mendim ~~edhe~~, politikë dhe koncept shoqëror ~~por edhe shoqëror~~. Manifestimi politik dhe shoqëror i islamit tek Izetbegović përshkruhet kështu: “feja+politika=islam, dituria+puna=islam, shkenca + aksioni = islam”, pra islami shihet si normë ri-gjeneruese aktive shoqërore.

Në veprën “Islami ndërmjet lindjes dhe perëndimit” shtjellohen tema filozofike, sociale, politike. Atyflitet për marksizmin, socializmin, përplasjet mes ideologjive fetare, moralin, religjionin, humanizmin, civilizimin, kulturën, artin.

Sipas Izetbegovićit në Krishterizëmbizotëron koncepti i bashkësisë shpirtërore, tek Judaizmi koncepti i klasës shoqërore, kurse islami ka konceptin e xhematit.⁷⁷

Shtegdalja nga krizat e kohës, nga absurdi i jetës moderne është devocioni, ~~ku me devocion nënkuptohet gjegjësisht~~ islami. ~~Devocioni sipas Izetbegovićit është nocioni apo çelësi i qëndrimit të brendshëm të njeriut ndaj botës dhe rezultateve të saj, pra devocioni është fati i njeriut.~~

⁷⁷ Alija, Izetbegović, “Vepra 2”, 2013, fq. 73-74.

3.4. Problemet e rilindjes islame

Libri *Problemet e rilindjes islame* është përmbledhje e artikujve, eseve dhe shkrimev publicistike të viteve 60-80 të shekullit XX. Në këto shkrime Izetbegoviqi përdor një stil të ashpër, të zjarrtë, revolucionar dhe frymëzues, duke tentuar që të gjejë rrugëdalje ngangathtësia shumëdekadëshee muslimanëve.

Në të iu qaset problemeve bashkëkohore të islamit, atyre të shekullit XX, duke ofruar një platformë të rilindjes. .

Fjalitë frymëzuese, koncize dhe revolucionare të Izetbegoviqit japin shpresë për rizgjim të islamit muslimanëve. Nga konteksti shkrimor vërehet se Izetbegoviqi ka qenë njohës i mirë i rrethanave dhe problemeve shoqëro-politike të botës islame, duke i ndërlidhur me problemet islame të vendit të vet.

Te “*Problemet e rilindjes islame*” Izetbegoviqi merret me shkaqet e prapambetjes së popujve muslimanë, me rolin e gruas në islam, shkruan për Kur’anin Famëlart, islamin dhe bashkëkohësinë, shkruan për të Dërguarin e Zotit, revolucionin islam, muslimanët dhe problemin palestinez, mbi hixhretin, interpreton shkrime të perëndimorëve për Kur’anin, shkruan për komunizmin, socializmin dhe ballafaqimin e islamit me sfidat nacionale dhe sociale të kohës bashkëkohore.

Izetbegoviqi mundohet ta thyejë letargjinë e myslimanëve, ta kthejë atë aksion shoqëror. Ai heshtjen shumëvjeçare të islamit dëshiron ta transformoj në aksion politiko-shoqëror, duke theksuar se Islami si koncept, ide – është fe që synon edhe botën e jashtme edhe të brendshme, këtë botë dhe t tjetrën. Vërehet qartë se motivin për aktivizimin apo rizgjimin e islami Izetbegoviqi e gjen te arritjet e mëhershme të popujve muslimanë, të zbuluesit dhe shkencëtarë islamë të së kaluarës etj. Sipas tij islami kërkon trimëri, duhet të luftohet në vetë shoqërore (alkooli, bixhozi, prostitucioni etj). Myslimanët duhet të bashkëjetojnë në atmosferë vëllazërore⁷⁸ Ndërkohë flet edhe për barazinë e llojit human: Bas barazia njerëzore mund të shihet në Hutben Lamtumirës të Muhammedit (a.s.).

Izetbegoviqi thotë se gruaja-muslimane duhet të jetë aktive dhe e emancipuar, pjesëmarrëse në aktivitetet shoqërore dhe politike të kohës, në rilindjen islame.

Bashkëjetesa është një ndër shtyllat kryesore për zgjidhjen e problemeve të Lindjes së Mesme dhe të atij palestinez.

Sipas Izetbegoviqit komunizmi dhe islami janë dy revolucionet e rëndësishme në botë; revolucioni islam nënkupton revolucion në emër të Zotit, “ *luftimin e agresionit shpirtëror, ideor dhe politik, zbatimin e programeve arsimore, industriale, agrare, forcimin e rolit të familjes dhe gruas në shoqëri, luftën kundër veseve të këqija – alkoolit, bixhozit, prostitucionit dhe lirisë gabimisht të kuptuar, kundër shovinizmit...*”⁷⁹.

Në “ *Problemet e rilindjes islame*” Izetbegoviqi shkruan edhe edukimin e gjeneratës së re, dëshiron një gjeneratë të arsimuar, një plejadë të re të mendimit islam. Edukimi i gjeneratës sipas Izetbegoviqit duhet të ndërtohet mbi një sistem arsimor të fuqishëm.

Sipas tij ka tre lloje të luftës: politike (lufta për liri), kulturore (lufta për identitet) dhe lufta sociale⁸⁰.

Shkurt e shqip, “ *Problemet e rilindjes islame*” ngërthen shkrime për islamin aktiv, të gjallë, për islamin politik-shoqëror-social, për “socializmin islam”, alternativën islame.

⁷⁸ Alij Izetbegović, “ *Vepra 2*”, 2013, fq. 326.

⁷⁹ Po aty, fq. 389

⁸⁰ Po aty, fq. 406

Formatted: Albanian (Albania)

PËRFUNDIMI

Formatted: Albanian (Albania)

“*Islami politik*” padyshim se mbetet një ndër konceptet më komplekse në botën shkencore që nga fundi i shek. XIX deri në ditët tona. Nëpërmjet ndikimit mediatik global – media si “*fuqia e katërt*”, lehtësisht arrin që islamizmin ta ndërlidhë me “fundamentalizëm islamik”, “rrezik islamik”. Për islamistët modernistë nocioni *islamizëm* është formë e ideologjizuar e fesë dhe përfaqësuesit e tij islamin nuk e shohin vetëm si fe, por edhe si sistem politik e ideologjik.

Mendimtari boshnjak Alija Izetbegović konsiderohet një nga islamistët më të zëshëm ballkanas të fundshekullit XX. I ndikuar nga rrethanat historike dhe përjetimet jetësore, Izetbegović ishte nyja lidhëse e mendimit filozofik lindor dhe perëndimor. Ai në njërin anë nëpërmjet ndikimit filozofik perëndimor të Spenserit, Heideggerit, Hegelit, Albert Kamysë, dhe në anën tjetër i motivuar nga islamistët modernist anti-kolonial si Muhamed Ikbali, Abduhu, Kutubi, Meududi, Hasan el-Benna, arriti që të dëshmojë pjekurinë e tij intelektuale se islami përveçse është fe hyjnore, është edhe platformë sociale, botëkuptim me refleksione shoqërore.

Përmes punimit “*Koncepti i islamit politik tek Izetbegović*” jemi munduar që t’i analizojmë tri premisa kryesore:

a) analizën dhe gjenezën e definicionit “islam politik” dhe përfaqësuesit e tij, argumentet dhe kundër-argumentet mbi këtë koncept;

b) jetën dhe veprën e Alija Izetbegoviqit, jetën politike të tij, “islamin politik” në ish-Jugosllavi, parimet dhe principet e partisë politike të Izetbegoviqit (Stranka Demokratske Akcije) – shtrirjen dhe zhvillimin e saj në Sanxhak, Kosovë dhe Maqedoni dhe

c) analizë të veprave fetaro-politike të Izetbegoviqit: “*Deklarata Islame*”, “*Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit*” dhe “*Problemet e rilindjes islame*”.

Nga analiza e islamit politik konstatojm se kjo sintagmë është fluide, përkufizohet në mënyra divergjente, shpesh me kuptim pezhorativ.

“Stranka Demokratske Akcije” edhe pse ishte parti e ndërtuar mbi themelet dhe principet e rrethit kulturor-mysliman, nuk ishte e ndërtuar mbi “islamin politik”. Argumenti më i fuqishëm për këtë janë 16 pikat programore të saj, ku në asnjë vend nuk mund të gjejmë definicionin “islam politik”. Këtu lirisht mund të theksojmë se në ish-Jugosllavinë e viteve 90-ta të shekullit XX, shohim zgjim të lëvizjeve islame në këto troje, por jo edhe islam politik.

Islamin politik tek Izetbegoviqi e shohim nëpërmjet në veprat “*Deklarata islame*”, “*Problemet e rilindjes islame*” dhe “*Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit*”, veçanërisht tek dy librat e parë, “*Deklarata islame*” dhe “*Problemet e rilindjes islame*” të shkruara gjatë viteve 60-80 të shekullit XX, shohim dëshirën e flakët të Izetbegoviqit për rizgjim, ringjallje islame dhe aksion islamik.

Izetbegoviq ka shkruar për frymën e kohës duke dëshiruar një të ardhme më të mirë për atdheun dhe fenë e tij.

Ndryshe, mendimet dhe idetë e Izetbegoviqit mund të ndahen në dy periudha: periudha komuniste dhe periudha pluraliste –pas 90-tave. Në periudhën komuniste shohim dëshirën e flaktë për “shtet islam” – islamizim, ndërsa në periudhën pluraliste pas 90-tave, gjatë fjalimeve të tij politike nëpër tubime, mitingje dhe konferenca ndërkombëtare, shohim një Izetbegoviq që dëshiron një Bosnje dhe Hercegovinë të pavarur, qytetare dhe demokratike, shtyllat kryesore të së cilës janë barazia-drejtësia. Alija Izetbegoviq, intelektualisht shihet si “islamist”, ndërsa politikisht vepronë në bazë të kontekstit evropian-perëndimor.

Bibliografia

- 1) Ayoob, Mohammed, *The many faces of Political Islam – religion and politics in the Muslim World*, bot. The University of Michigan Press, 2008.
- 2) Aziri, Etem, *Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni*, Logos-A, Shkup, 2004.
- 3) Aziri, Etem, *Partitë politike dhe demokracia*, Logos-A, Shkup, 2004.
- 4) Bayet, Asef, *Post – İslamcılık Siyasal İslam'ın değişen yüzü*, Litera Yayıncılık, İstanbul, 2016.
- 5) Dağg, Emin Ahmet & Pajaziti, Ali, *Fjalor i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe i diplomacisë*, Logos-A, Shkup, 2019.
- 6) Davutoğlu, Ahmet *Aliya Modeli ve Bosna'daki Liderlik Yapılanması*, *Aksiyon*, nr.94, Stamboll, 1994.
- 7) Ekinci, U. Mehmet, *Bosna-Hersek Siyasetini anlama kılavuzu*, SETA – Siyaset, Ekonomi ve Toplum Araştırmaları Vakfı, Ankara, 2014.
- 8) Ekinci, U. Mehmet, *Sırbistan Siyasetini anlama kılavuzu*, SETA – Siyaset, Ekonomi ve Toplum Araştırmaları Vakfı, Ankara, 2014.

Formatted: Albanian (Albania)

- 9) Esposito, L. John, *Fjalori i Oksfordit për Islamin*, Logos-A, Shkup, 2017.
- 10) Frashëri, Sami, *Vepra 10*, Logos-A, Shkup, 2004.
- 11) Fuller, E. Graham, *The future of political islam*, botimi: Palgrave Macmillan, New York, 2004.
- 12) Ibrahim Nexhat, *Fjalori enciklopedik islam*, Logos-A, Shkup, 2017.
- 13) Ibrahim, Nexhat, *Vepra 1*, Logos-A, Shkup, 2009.
- 14) Ibrahim, Nexhat, *Vepra 10*, Logos-A, Shkup, 2009.
- 15) Ibrahim, Nexhat, *Vepra 3*, Logos-A, Shkup, 2009.
- 16) Islam Ansklopedisi – Türkiye Diyanet Vakfı /ISAM, vëllimi 23, Istanbul, 2001.
- 17) Islami, Islam, *Egjypti ndërmjet shekullarizimit etatist dhe islamizmit politik* (punim doktore), [Universiteti i Europës Juglindore](#), 2018.
- 18) Izetbegović, Alija, *Odabrani—Odabrani govori, pisma, izjave, intervjui*, Prvo muslimansko dioničko društvo, Zagreb, 1995.
- 19) Izetbegović, Alija *Kujtimet*, botimi: Asociacioni për Kulturë, Edukim dhe Arsim – AKEA, Prishtinë, 2008.
- 20) Izetbegović, Alija, *Vepra 3 - Ikja ime në liri – shënime nga burgu (1983-1988)*, Logos-A, Shkup, 2013.
- 21) Izetbegović, Alija, *Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit*, Logos-A, Shkup, 2009.
- 22) Izetbegović, Alija, *Vepra 1*, Logos-A, Shkup, 2013.
- 23) Izetbegović, Alija, *Vepra 2*, Logos-A, Shkup, 2013.
- 24) Izetbegović, Alija, *Vepra 4*, Logos-A, Shkup, 2013.
- 25) Izetbegović, Alija, *Vepra 5*, Logos-A, Shkup, 2013.

- 26) Kallën, Ibrahim, *Islami dhe Perëndimi*, Logos-A, Shkup, 2011.
- 27) Karçiq, Fikret, *Myslimanët e Ballkanit – “çështja lindore” në shekullin XX*, ALSAR, Tiranë, 2016.
- 28) Kariq, Enes & Çançar, Nusret, *Fundamentalizmi islam: Ç’është ky?*, Logos-A, Shkup, 2011.
- 29) Köse, Ali, *Evropa dhe Islami*, Logos-A, Shkup, 2015.
- 30) Kutluer, İlhan, *İslamcılık*, vëll. 23, DİA, İstanbul, 2001.
- 31) Muslimovic, Fikret / Cikotic, Selmo, *Mislilac i drzavnik – Alija Izetbegovic*, botimi: Muzej “Alija Izetbegovic”, Sarajevo, 2016.
- 32) Pajaziti, Ali, *Fjalori i Sociologjisë*, Logos-A, Shkup, 2017.
- 33) Pajaziti, Ali, *Islamët shqiptarë – trendët, lëvizjet dhe aktorët e rinj islamikë në albanosferë në 25 vitet e tranzicionit: një vështrim sociologjik*, Samizdat, Shkup, 2018.
- 34) Roy, Olivier, *Failure of Political islam*, Harvard University Press, Cambridge-Massachusetts, 1994.
- 35) Said, W. Edward, *Shtrembërimi i Islamit*, Logos-A, Shkup, 2011.
- 36) Sarıkaya, Berat, *Aliya Izetbegović’in düşünce dünyası ve inancını şekillendiren tarihsel arkaplan*”, *Turkish Studies – Comparative Religious Studies*, Volume 13/25, Skopje/Macedonia – Ankara/Turkey, Fall 2018.
- 37) Seriali “ ALIJA ” i Radio Televizionit Turk – TRT 1, viti i realizimit: 2018, 6 pjesë
- 38) Tarik Kulenović, *Islami politik – konceptet themelore, autorët dhe grupet e një lëvizjeje moderne*, Logos-A, Shkup, 2012.
- 39) TDV Islam Ansiklopedisi “ *Izzetbegović Alija* ”, vëllimi shtesë (turqisht: EK-1), Stamboll, 2016.

40) Демири, Бејтула; “Ислам и политика – политичко искуство на муслиманите”; Логос-А, Скопје, 2009.